



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri
Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”
Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi

Prof. Asoc. Elson Agastra

Gusht 2020

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROÇES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (KU "IKT") është themeluar në vitin 2011, përmes licensës për hapjen e programeve Bachelor, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 10/11/2011 "Për licencimin e 'Instituti Kanadez i Teknologjisë'". Filozofia e "Institutit Kanadez të Teknologjisë" është t'i ofrojë dhe pajis studentët me arsimin dhe aftësitë cilësore të nevojshme për tregun e punës shqiptar, evropian dhe më gjerë.

KU "IKT" është institucion i akredituar fillimisht në vitin 2016, përmes Urdhërit të MAS, Nr. 139, datë 25.03.2016. Më pas KU "IKT" është akredituar institucionalisht edhe në vitin 2017, duke marrë "Certifikatën e Akreditimit" prej Bordit të Akreditimit të ASCAL, sipas vendimit të këtij bordi Nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare.

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni të KU IKT ofrohet nga **Departamenti i Inxhinierisë Software**, që është një pjesë integrale e **Fakultetit të Inxhinierisë**.

Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë në fuqi, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademik i organizuar në 180 kredite ECTS. Kurrikulat tërësisht në gjuhën angleze, sigurojnë që KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë" të përdorë materialet mësimore më të fundit, duke plotësuar filozofinë e tij ndaj studentëve në rrugën e tyre të kërkimit të diturisë dhe profesionalizmit. Këto janë elementë thelbësorë për tregun e punës në Shqipëri por edhe jashtë tij.

Qëllimi i programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni është i projektuar për të pajisur studentët me njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të diplomuarit drejt një profili profesional, si p.sh. analist i sistemeve të informacionit, specialist sistemeve hardware, databazash për sistemet informative, zhvillues sistemesh apo për të vazhduar studime të mëtejshme pasuniversitare. Programi synon të kombinojë teorinë mbi shkencat kompjuterike dhe informatike në tërësi dhe praktikën në lidhje me analizën, projektimin dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit. Kjo arrihet duke ndërthurur shkencat kompjuterike me njohuri të shkencave të menaxhimit dhe aspekte të proceseve vendim-marrëse. Ai ka për qëllim të theksojë veçanërisht punën në grup, duke menduar në mënyrë të pavarur dhe inovative dhe cilësitë e lidërshiptit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 19.06.2019, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017", Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni".

ASCAL nëpërmjet procedurave institucionale ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të ekzaminuar dokumentacionin e përcjellë nga KU "IKT", për të kryer vizitën në ambientet e institucionit dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm, si më poshtë:

Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi, pedagog në Universitetin Politeknik të Tiranës;

Prof. Asoc. Elson Agastra, pedagog në Universitetin Politeknik të Tiranës,

Koordinator teknik në këtë procedure është ME. Renata Qatipi.

Parimet e Punës së GVJ

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Shkurt 2020 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

GVJ së bashku me specialisten e ASCAL, ME. Renata Qatipi, vizitoi KU IKT në mënyrë të organizuar në data 15 dhe 16 Qershor 2020. GVJ zhvilloi diskutime me Rektorin, Zv Rektoret dhe Dekanin e Fakultetit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), stafin akademik të Departamentit si dhe me pedagogë të angazhuar në programin e studimit.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor në këtë kohë në KU IKT. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Më datë 16.07.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 86/8 Prot., datë 16.07.2020 "Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", KU "IKT" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

KU CIT përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft–Raportin, me shkresë Nr. 363 Prot., datë 23.07.2020 “Mbi Draft-RVJ në kuadër të akreditimit të parë të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”. Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e KU “IKT” sqaron si më poshtë:

Komenti i KU “IKT”:

- Kapitulli tre, “Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat”, ka në total 8 (tetë) standarde, prej të cilave 6 (gjashtë) janë “përbushen plotësisht” dhe 2 (dy) janë “përbushën kryesisht”, ndërkohë që në shkallën e përbushjes së standardeve për fushën III në fund të kapitullit, figuron që vlerësimi përfundimtar është “përbushet kryesisht”. Vlerësojmë se, pavarësisht peshës së standardeve, nëse 6 (gjashtë) standarde janë të përbushura plotësisht dhe vetëm 2 (dy) kryesisht, vlerësimi përfundimtar në shkallën e përbushjes duhet të ishte “përbushen plotësisht”.

GVJ: Vlerësimi në tërësi i kapitullit III-të, “Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat” synon me anë të gjetjeve në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe konstatimeve gjatë vizitës në institucion, të evidentojë dhe të nxjerr në pah mangësitë nëse ka të tilla. Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe raporti vjetor drejtuar MASR rezulton se përgjatë tre viteve të fundit akademike 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020, stafi akademik efektiv i Departamentit të Inxhinierisë Softëare ka ndryshuar respektivisht: 57 %; 42 %; 42%. Nga ana e institucionit KU IKT vërehet një nivel i lartë përgjegjshmërie në plotësimin e standardeve, dhe kjo demonstron në plotësimin e standardeve në pjesën më të madhe të kriterëve të këtij kapitulli. GVJ mbasi rikonsultoi edhe njëherë të gjitha materialet në dosjen DVV duke marrë në konsideratë edhe dëshirën e madhe të institucionit për të pasur qëndrueshmëri të stafit pavarësisht se në tre vitet e fundit akademik vërehen lëvizje, për të qenë sa më objektivë drejt realitetit që këto lëvizje mund të jenë rastësore, apo edhe të lidhura edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm mendon që Standardi III.2 “Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira”.

Vlerësimi i Kapitullit 3 ndryshon nga “Përbushet Kryesisht” në “Përbushet Plotësisht”.

Komenti i KU “IKT”:

- Kapitulli IV, “Burimet njerëzore, financiare...” ka në total 6 (gjashtë) standarde, prej të cilave 4 (katër) janë “përbushen plotësisht” dhe 2 (dy) janë “përbushën kryesisht”, ndërkohë që në shkallën e përbushjes së standardeve për fushën IV në fund të kapitullit, figuron që vlerësimi përfundimtar është “përbushet kryesisht”. Vlerësojmë se, pavarësisht peshës së standardeve, nëse 4 (katër) standarde janë të përbushura plotësisht dhe vetëm 2 (dy) kryesisht, vlerësimi përfundimtar në shkallën e përbushjes duhet të ishte “përbushen plotësisht”.

GVJ: Vlerësimi në tërësi i kapitullit IV, dhe në veçanti garantimi i cilësisë së personelit që mbulon programin e studimit si dhe aftësia financiare e institucionit për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit nuk mund të jetë një vlerësim i pastër matematik. Aq më tepër që bazohet në dokumentacion të paraqitur nga KU IKT si dhe shpjegimet e kërkuara gjatë vizitës në institucion.

Për sa më sipër, në standardin IV.2 dhe IV.6, dokumentacioni i paraqitur nuk ka qenë i mjaftueshëm për të vlerësuar me objektivitet përbushjen e standardit nga ana e institucionit.

Për këtë motiv, edhe gjatë vizitës në institucion janë kërkuar sqarime, dhe në veçanti për Raportin Institucional [dok. 26, Raport Institucional për MASR 2018-2019] dhe mos përputshmëria e tij me tabelat e paraqitura në RVB. Sqarimet kanë qenë të paqarta dhe kontradiktore me vetë raportin. Kujtojmë që gjatë vizitës në institucion nga KU IKT është mbrojtur fakti i mospërputhshmërisë së të dhënave me faktin se raporti i sipërcituar është draft. Ky konfirmim bie ndesh me datën e përpilimit të tij e cila është në mbyllje të vitit akademik dhe jo në fillim të tij që mund të jetë draft.

Gjetjet në këtë pikë janë kontradiktore në vlera financiare që ndryshojnë edhe me 50% në deklarime të ndryshme për të njëtin vit akademik.

Ndryshime janë gjetur jo vetëm midis raportit të sipërcituar dhe RVB, por edhe midis dokumentave të tjera si ai i buxhetit sipas njërive kryesore [dok. 64, Buxheti sipas njërive kryesore] dhe tabelave përkatëse në RVB.

GVJ, duke mos paragjykuar vullnetin e mirë të institucionit për të ofruar të dhëna të sakta dhe të vërtetueshme, e vlerëson plotësimin e Kapitullit 4 si “Përmbushet Kryesisht”.

Ky vlerësim ka qëllimin e mirë të ndihmojë institucionin në arritjen e standardeve gjithnjë e më të larta me vënien në dukje të gjetjeve si dhe gjithashtu ti japi një tablo sa më objektive Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e dhe bordit përkatës në mënyrë që të kërkojë, nëse e mendon të arsyeshme informacione shtesë për vendimmarrje.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon

Komenti i KU “IKT”:

- Në standardin I.4, kriteri 1, të Kapitullit të parë, konstatohet prej GVJ se: “vërehet një ndryshim jo i zakonshëm i stafit efektiv të departamentit e cila mund të shkaktojë luhajtje të aktivitetit të departamentit” dhe pak më poshtë se “Departamenti dhe institucioni mund të bëjë më tepër për të siguruar një qendrueshmëri më të mirë të stafit akademik...”. Vlerësojmë se nga ana e KU “IKT” janë marrë të gjitha masat që stafi akademik të jetë i qendrueshëm dhe se Fakulteti i Inxhinierisë, ashtu si dhe vet institucioni, nuk kanë larguar askënd nga detyra e tij, por këto lëvizje, janë pasojë e ndryshimeve në tregun e punës, emigracionit të specialistëve, si dhe faktit se Ligji i Arsimit të Lartë, i cili e ndan stafin akademik sipas tre kategorive, ka përcaktuar se për stafin akademik me kualifikim “Master i Shkencave”, kontratat të jenë me afat të përcaktuar, gjë e cila pavarësisht dëshirës së mirë që ka institucioni për t’i mbajtur, shkakton vështirësi. KU “IKT” është munduar që gjatë këtyre viteve t’u krijojë kushte të favorshme punë të tërë anëtarëve të stafit akademik, dhe në asnjë moment prej tyre nuk ka pasur vërejtje për institucionin.

GVJ: Komentit është dhënë përgjigje në paragrafin e 1-rë.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon

Komenti i KU “IKT”:

- Në standardin IV.2, kriteri 4, të Kapitullit të katërt, konstatohet prej GVJ se: “vihet re një angazhim i ulët i këtij stafi (të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike – shënimi ynë) në këtë program studimi” dhe më poshtë jepet angazhimi i stafit në mënyrë numerike duke marrë për bazë departamentin se nga vjen. Theksojmë se, programi që po akreditohet është një program i ciklit të parë dhe se lëndë/modulet në të cilat angazhohet stafi akademik i departamentit ku

është programi i studimit, janë të pakta duke qenë se lëndë të tilla si: Calculus I, II, III, Linear Algebra, Introduction to Statistics, Introduction to Economy, Engineering Chemistry, Fundamentals of Physics, apo lëndë/modulet e tjera si Academic Reading and Writing I-II, Ethics etj., janë lëndë që nuk mund të mbulohen nga një staf akademik i specializuar në fushën e inxhinierisë softuerike apo fusha të ngjashme. Për këtë arsye, duke qenë se është program i ciklit të parë dhe baza e lëndëve formuese është më e madhe, është angazhuar një staf me përgatitje profesionale edhe nga departamentet e tjera brenda fakultetit, por që është ekspert në fushën përkatëse. Për Fakultetin e Inxhinierisë e rëndësishme është që pedagogët që mbulojnë lëndët të jenë profesionist dhe të specializuar në fushat e ekspertizës për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe efikasitetin e mësimdhënies.

GVJ: Në këtë pikë, sikurse shpjegohet edhe në vlerësimin përkatës të paraqitur në kriterin 4 të standardit IV.2, mund të përmirësohet nga ana e Institucionit KU IKT angazhimi i stafit të departamentit përgjegjës për programin e studimit në formimin e studentëve në drejtimin “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”.

Vërtet që programi i studimit është i nivelit bachelor, por bazuar edhe në ndarjen e lëndëve në tipe të veprimtarisë (VKM nr. 41, dt. 24.01.2018) të paraqitura edhe në tabelën 9 në RVB, lëndët që citoni zenë maksimumi 43% të totalit të krediteve të këtij programi studimi. 53.3% janë lëndë karakterizuese të programit të studimit dhe 3.3% janë detyrime përmbyllëse.

Nëse i referohimi kësaj ndarje, lëndët karakterizuese duhet të mbulohen në pjesën më të madhe nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, pra rreth 50%. Kjo garanton vazhdueshmërinë e programit të studimit me objektivat e zhvillimit të departamentit përgjegjës për programin e studimit.

Në rastin konkret, edhe pse lëndët mbulohen me pedagogë/staf akademik të kualifikuar, por duke mos qenë ata pjesë e departamentit, ristrukturimi/riorganizimi i një apo disa departamenteve të tjerë edhe për përmirësim të objektivave të tyre, do të kishte një ndikim jo të vogël edhe në këtë program studimi.

Në këtë rast sugjerohet që ngarkesa e departamenteve të tjera në mbarëvajtjen e këtij programi studimi të ulet.

Kujtoj që nga analiza, peshën më të madhe në formimin e studentëve të këtij programi studimi e ka Departamenti i Inxhinierisë Industriale dhe jo ai i Inxhinierisë Softuerike. Një riorganizim i mundshëm i Departamentit të Inxhinierisë Industriale mund të sillte vështirësi në ecurinë normale të programit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" duke mos qenë ai departament përgjegjës për këtë program studimi.


Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon

Komenti i KU “IKT”:

- Në fund të draft-raportit, në Shkallën e Përbushjes së Standardeve të Cilësisë për Programin, i cili në total ka 6 (gjashtë) fusha vlerësimi (kapituj), prej të cilave 4 (katër) “përbushen plotësisht” dhe 2 (dy) “përbushen kryesisht”, jepet vlerësimi tërësor (përfundimtar) “përbushen kryesisht”. Vlerësojmë gjithashtu se pavarësisht peshës së kapitujve, nëse raporti i fushave të vlerësimit është 4 (katër) me 2 (dy), atëherë vlerësimi përfundimtar do të jetë më tepër nga “përbushen plotësisht”, sesa në “përbushen kryesisht”.

GVJ: GVJ duke rivlerësuar bazuar në komentet dhe përgjigjet e mësipërme si dhe duke vlerësuar anagazhimin maksimal të institucionit për të sjellë jo vetëm një kurrikul bashkëkohore dhe mjaft të kërkuar në treg, por edhe për të sjellë një model si universitet bazuar në modelin kanadez-amerikan vlerëson përfundimisht 5 fusha veprimi (kapituj) në “përbushen plotësisht” dhe 1 fushë veprimi (kapitull) në “përbushen kryesisht”. Vlerësimi përfundimtar në “përbushen plotësisht” duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për fushat ku shfaqen pamjaftueshmëri dhe mangësi.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. <i>Referencë: Statuti i Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i teknologjisë” neni 4.</i>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë duke kontribuar në përgatitjen e brezit të ri të inxhinierive në fushën e kompjuterave dhe të teknologjisë së informacioni.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbyllen me njohuri specifike në fushën e kompjuterave dhe teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë". <i>Referencë: Rregullorja Institucionale e KU CIT e vitit 2016, neni 7.</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. <i>Referencë: DVV, RVB, Plani mësimor</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 8

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Grupi i vleresimit të jashtëm GVJ kostatoi përmes konsultime me të gjithë dokumentacionin e venë në dispozicion (rregulloret bazë, dokumentat e strategjisë ekzistuese dhe të përditësuara) si dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të KU IKT-së se program i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të KU IKT 2024”			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcakton qartë përparësitë e tij akademike dhe demonstroi që programet e studimit hartohen dhe sigurohen në përputhje me këto të fundit. Referuar Nenit 2 dhe Nenit 4 të Statutit të Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit KU IKT-së. Institucioni, i mbështetur gjithashtu në disa Strategji Kombëtare, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën digjitale të përpunimit dhe të transmetimi të informacionit. Në strategjinë e përditësuar institucioni KU IKT-së ka përcaktuar qartë objektivat në Nenin 4, të cilat janë kërkesa bashkëkohore mëse të realizueshme si për stafin akademik por edhe kërkesa për brezin e ri të inxhinierive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Objektiva të programit të studimit mund të veçojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të krijojë, të transmetojë dhe të zhvillojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor me qëllim zhvillimin e shoqërisë, - Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në të gjitha nivelet e studimit; - Të ndihmojë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe madje pretendohet në nivel botëror; - Të ofrojë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë; - Të kontribuojë në rritjen e standardeve demokratike të shoqërisë dhe

	<p>me përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kryejë studime dhe thellime në fusha të veçanta; - Të ofrojë specializim dhe kualifikim të mjaftueshëm. <p>Programi i studimit ofron të gjitha aftësitë dhe njohuritë që organizohen sipas skemës së llojit të lëndëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, duke shfrytëzuar modele të programeve të ngjashme kanadeze, duke synuar në përgatitjen e një brezi të inxhinierve të rinj jo vetëm zbatues të inxhinierisë së kompjuterve por edhe innovator dhe programues duke synuar në një fushë më të gjerë të lëndëve që mund të trajtohen në të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni KU IKT-së ka kryer një studim të tregut të punës për fushat në degët e tjera të veprimit përgjatë vitit 2010 dhe ka paraqitur studimin në Shkurt 2011. Gjithashtu institucioni para hapje së programit të studimit ka realizuar një studim të thellë të tregut dhe të degëve të ngjashme aktuale në universitete publike dhe private në vënd.</p> <p>Në raportin e përgatitur në vitin 2016 del qartë kërkesa e madhe në vend për specialist në fushën e inxhinierisë kompjuterike, të inxhinierisë software dhe të sisteme digjitale të përpunimit dhe transmetimit të informacionit.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë (kryesisht në vitin e parë) të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve me një bagazh të gjerë, të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit më të specializuar.</p> <p>Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të KU IKT, Departamenti i Inxhinierisë së Software-it synon në krijimin dhe mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve. Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Institucioni e ka përshkruar qartë në statutin e tij fushat prioritare të zhvillimit të tij dhe si rezultat Departamenti i Inxhinierisë së Software-it është krijuar bazuar në praktikën më të mirë nga Universitetet Perëndimore. Dhe që nga ajo kohë, administrata ka punësuar personel akademik të kualifikuar, i ka ofruar Departamentit të gjitha lehtësitat për të zhvilluar leksione me cilësi të lartë, dhe seanca laboratorike me cilësi të lartë, <i>por vërehet një ndryshim jo i zakonshëm i stafit efektiv të departamentit e cila mund të shkaktojë luhatje të aktivitetit të departamentit.</i></p> <p>Mjetet ndihmëse si klasat ofrohen në një godinë me cilësi të lartë të leksioneve, duke përfshirë tabela, kompjuterë dhe laboratorë kompjuterash, laboratorë elektronikë deri diku të kufizuar. <i>Departamenti dhe institucioni mund të bëjë me tepër për të siguruar një qëndrueshmëri më të mirë të stafit akademik dhe të përmirësimit të laboratoreve bashkëkohore.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të stafit akademik të departamentit. Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e Nenit 86 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nuk rezultoi e aprovuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sidoqoftë, në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni rezultoi se KU IKT ka zbatuar kodifikimin e vet të programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe një nga objektivat kryesore është të trajtojë inxhinierë me aftësi të larta që janë të gatshëm për punë të mëtejshme akademike dhe për tregun konkurrues të punës. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinor, lëndët ofrohen nga njësi të ndryshme bazë, por secila lëndë mban kodin e njësisë bazë përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit</p>	<p>Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit duke caktuar detyra për njësitë dhe stafin sipas përgjegjësive përkatëse.</p> <p>Ndarja e detyrave mirëorganizohet në fillim të vitit akademik dhe</p>

<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>aprovohet nga Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë. Institucioni dëshmon se në fund të vitit akademik gjenerohet raporte të brëndshme për mbarvajtjen e detyrave të caktura.</p> <p>Disa shembuj të tjerë të zakonshëm janë: a) mbikëqyrja e tezave të përbashkëta nga dy ose më shumë profesorë të Departamenteve të ndryshme, b) ndarja e pajisjeve dhe laboratorëve të përbashkët, c) ndjekja e studentëve përgjatë vitit akademik si dhe orjentimi për praktikën profesionale dhe punimin e diplomës.</p> <p><i>Referencë: DVV, Rregullore e Departamentit Inxhinieri Softuerike shqip-anglisht.pdf, Art. 2</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në DVV [dok.44 a-d Marreveshjet institucionale të KU IKT_opt.pdf] institucioni i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione homologe të arsimit të lartë në Shqipëri si dhe jashtë saj si dhe me kompani private në vënd. Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucioneve e subjektsh të tjera si shtetërore ashtu edhe private. Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes këtij procesi për të mundur angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal nga ana e tyre. Gjithashtu, praktikat (sidomos të vitit të fundit) shikohen edhe si një mundësi për t'u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të inicuar punësimin e tyre të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike i cili është përgjegjës për programin e studimit, harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, në kontekstin e realizimit të programeve të studimit. Këto raporte analizohen në departament dhe dekanat më pas u vihen në dispozicion zyrave respektive të Kërkimit Shkencor, Projekteve, Aplikimit dhe Inovacionit si dhe Zyrës së marrëdhënieve me studentët. Problematikat e raportuara shërbejnë për të korigjuar tematikat e bashkëpunimit në funksion të programit të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni KU IKT dëshmon me kontratat që ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë kompani private në vënd si dhe institucione shtetërore për realizimin e praktikës mësimore. Bazuar në dokumentacionin në dosje DVV [RVB, Tab 5, dok.44 a-d Marreveshjet institucionale të KU IKT_opt.pdf] numri i kompanive dhe institucioneve shtetërore është rreth 15.</p> <p>Për të dhënë më tepër rëndësi edhe bashkëpunimit ndërkombëtar KU IKT demonstron se ka vendosur lidhje dhe ka realizuar mobilitete për studentët në degë të tjera me universitet dhe qendra të huaja në shtete si Itali, Turqi, USA dhe Rumani. Për shkak të situatës së pandemisë për studentët e programit të studimit në fjalë nuk mund të realizonin praktika mësimore jashtë vendit në këtë vit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim</p>	<p>Institucioni KU IKT-së aktualisht është në brezin e parë të studentëve të diplomuar, në rregulloren e programit të studimit bazuar në misionin dhe strategjinë e tij ky institucion synon në ofrimin e trajnimeve të</p>

me punëdhënësit.	mëtejshme profesionale të studentëve të diplomuar. Për këtë në bashkëpunim me disa kompani, institucioni planifikon të zhvillojë workshop me qëllim promovimin e dijeve të studentëve dhe lidhje më të ngushta me tregun e punës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së programit të studimit, programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” i ofruar nga KU IKT-së i liçensuar nga MASR me Nr.564 datë 02.12.2016 si program i Ciklit të parë i organizuar në 180 kredite ECTS sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).</p> <p>Nga analizimi i programit të studimit rezulton se ky program është i organizuar në module me vlerësim në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kreditet që duhet të plotësohen për të përfunduar me sukses programin Bachelor janë 180 ECTS. Programi Bachelor realizon çdo vit 60 kredite ECTS. Programi i studimit është plotësisht konform legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB, Plani mësimor</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>Programi mësimor i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Programi i studimit i Inxhinierisë Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni korespondon me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> Njohuri e përparuar e një fushe të punës ose studimit, që përfshin një kuptim kritik të teorive dhe parimeve në fushën e kompjuterave;

	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësi të përparuara, demonstrim të zotërimit dhe inovacionit, të nevojshme për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar të punës ose studimit. • Menaxhimi i veprimtarive komplekse teknike, profesionale ose projekteve, duke marrë përgjegjësinë për vendimmarrjen në kontekste të paparashikueshme të punës ose studimit. Marrja përsipër e përgjegjësi për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve dhe grupeve.
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve me një bagazh të gjerë, të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit më të specializuar. Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të KU IKT-së, Departamenti i Inxhinierisë Softuerike synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve. Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të cilat pasqyrohen tek syllabuset e çdo lënde të cilat janë në përputhje me ato të programit. Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; b. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; c. Formim qytetar të përgjithshëm; d. Aftësi bazë për punë kërkimore; e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; f. Aftësim për promovim personal; g. Diplomë pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse. <p>Përgatitja gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet në nivelin e dytë të studimeve. Kërkesat e tregut të punës për specialistë që diplomohen në këtë profil janë në rritje, ndaj programi i studimit synon plotësimin e tyre me të diplomuar cilësorë.</p> <p><i>Referencë: Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në</p>	<p>Duke analizuar programin e studimit dhe silabuset përkatëse vërehet se elementët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” janë në përputhje të plotë me Vendimin e</p>

akte ligjore e nënligjore.	<p>Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".</p> <p>Tipologjitë e lëndëve janë ndryshuar sipas rregullores së re, e cila ka pesë lloje lëndësh kur krahasohet me atë të mëparshmen që ka gjashtë lloje lëndësh. Plani mësimor (kurrikula) dhe syllabuset e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI janë në përputhje të plotë me VKM-në e sipërpërmendur.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI është një program studimi i ciklit të parë. Ai ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 kredite. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit në Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimi është anglisht.</p> <p>Frekuentimi i procesit mësimor (leksione/ushtrime/ seminare /laboratorë/ projekte/ punim i diplomës) është i detyrueshëm në masën 75%.</p> <p>Pas përmbushjes së kriterëve për diplomim nga programi i studimit në fjalë sipas rregullores së programit të studimit, studentit i jepet diploma "Bachelor".</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët sipas kategorive të caktuara dhe ngarkesës përkatëse të krediteve. Grupimi i lëndëve bëhet brenda normave ligjore në fuqi sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Departamenti mund të propozoj ndryshime në kurrikula bazuar në zhvillimet ndërkombëtare dhe kombëtare, duke respektuar legjislacionin kombëtar. Nga periudha e leçensimit nuk janë bërë ndryshime në programin e studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe moduleve, bazuar në <i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar</i>, ndarja në kategoritë është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 30 ECTS (16.6%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues: 96 ECTS (53.5%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 30 ECTS (16.6%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 18 ECTS (10%) - Kategoria E (detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%) <p>Numri i përgjithshëm i disiplinave (të thjeshta ose të organizuara në module) të nevojshme për t'u diplomuar, së bashku me Tezen është 32</p> <p><i>Referencë: DVV, Plani mësimor "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI"</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike i cili ofron programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI, plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Departamenti i Inxhinierisë Softuerike përbëhet nga 7 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët, 1 me gradën shkencore Prof. Dr, 4 me gradën shkencore "Doktor", 1 Doktor në process dhe 1 MSc. Gjithashtu në këtë vit akademik departamenti ka angazhuar edhe 3 staf akademik me kohë të pjesshme</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë. Fakulteti i Inxhinierisë plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili përbëhet nga 2 njësi bazë dhe qendra e kërkimit shkencor CIRD.</p> <p>KU ITK-së ka përmbushur standardet institucionale dhe ka marrë akreditimin fillestar dhe periodik në nivelin institucional Nr.33 datë 20.12.2017 për një periudhë 5 vjeçare, përpara se të aplikojë për akreditimin e programit të studimit.</p> <p>Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit plotësojnë kërkesat ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Njësia bazë ofron 4 programe të ndryshme studimi në 2 ciklet e studimit Cikli i I-rë dhe Cikli i II-të.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB, Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Inxhinierisë Softuerike në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit Inxhinieri Kompjuterike dhe TI kishte organizuar ndjekjen e problematikave të programit të studimit nga ana e Koordinatorit të Programit , i cili ndihmon në përmbushjen me sukses të objektivave të programit. Koordinatori për programin e studimit Bachelor i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" është caktuar konform Rregullores së Programit të studimit dhe është në proces doktorate.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia bazë përbëhet nga të paktën 7 pedagogë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre janë me</p>

<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>grada dhe tituj akademike.</p> <p>Kështu, në vitin akademik 2019-2020 stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 pedagogë me kohë të plotë (1 Prof.Dr; 4 Dr., 2 MSc (1 Dr në proces)) - 3 me kohë të pjesshme. (1. Prof.As, 2 Dr.) <p>Në vitin akademik 2018-2019 stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 pedagogë me kohë të plotë (5 Dr.; dhe 2 MSc (1 Dr nw process)) - 4 me kohë të pjesshme (1 Prof.As Dr, 3 Dr). <p>Në vitin akademik 2017-2018 stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 pedagogë me kohë të plotë (4 Dr. dhe 3 MSc) - 3 me kohë të pjesshme (2 Prof.As, 1 Dr). <p>Në vitin akademik 2019-2020, Fakulteti ka 21 pedagoge me kohë të plotë (77% të totalit), dhe 5 pedagoge me kohë të pjesshme (23%), si dhe një staf administrativ.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë kishte në total 562 studentë për vitin akademik 2019-2020, dhe raporti pedagog student është: 1:21.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike si njësi përgjegjëse për programin e studimit plotësojnë kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Referencë: Dosja DVV, RVB Tabela nr. 12/1, 12/2, 12/3</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Inxhinierisë si dhe njësia bazë Departamenti i Inxhinierisë Softuerike përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet minimale për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Çdo department dhe qendra janë se paku me 7 pedagog me kohë të plotë nga të cilët të paktën tre janë me grada dhe tituj akademike bazuar në dokumentacionin sipas dosjes RVB.</p> <p>Kështu, referuar dokumentacionit të dorëzuar, në vitin e fundit akademik 2019-2020, Fakulteti i Inxhinierisë, i KU CIT nga 26 staf akademik gjithsej, ka 21 pedagogë me kohë të plotë (pra 80.7% të stafit total), dhe 5 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <p>Pjesë e stafit të brendshëm PAE janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof.Dr; - 1 Prof.As.Dr; - 11 Dr; - 7 Msc (1 Dr. ne proces) <p>Në stafin e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.As.Dr, - 4 Dr

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Inxhinierisë, si njësi kryesore përgjegjëse për Programin Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Informacioni është i disponueshëm edhe në sekretarinë mësimore dhe i bëhet i ditur nga ana e kordinatorit të programit të studimit.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Program i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI është i organizuar në lëndë, trajnim profesional dhe praktika, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Raportet e lëndëve sipas kategorive përkatëse janë brenda normave ligjore në fuqi.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit plani mësimor i programit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite sipas sistemit kombëtar dhe evropian, të ndarë në vite akademike dhe semestra në të është informacioni i nevojshëm mbi lëndët për çdo semestër përfshirë edhe lëndët me zgjedhje. Çdo semestër ka 30 kredite dhe i gjithë programi i studimit ka 180 kredite. Lëndët janë të shpërndarë sipas veprimtarive formuese (A-E). Ky informacion u ofrohet studentëve përmes publikimeve të afishuara në ambientet e institucionit, si dhe në faqen e internetit si dhe nga ana e kordinatorit të programit të studimit. Ndarja në kredite/kategori është dhënë në kriterin 6/standardi II.1
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Bazuar në dosjen e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe TI” ai përmban programe të detajuara lëndore (syllabuse), të cilat përfshijnë informacionin e nevojshëm për ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë auditorit, ndjekjen e programit dhe metodat e vlerësimit të njohurive, etj. Syllabusi u prezantohet studentëve në ditën e parë të orës së mësimit. Gjithashtu, të gjitha syllabuset publikohen në faqen kryesore web të universitetit. Të gjitha syllabuset për të gjitha lëndët e ofruara ishin lehtësisht të aksesueshme. Vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive - 10% • Plotësimi i detyrimeve (kuizeve, studimeve të rastit, detyrave/projekteve të kursit) - 20-30% • Provimi i Ndërmjetëm - 25-35%

	<ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar - 30-40% <p>Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, kolokiume, leksion/seminare, seminare/laboratorë) është i detyrueshëm në masën 75% (shtatëdhjetë përqind).</p> <p><i>Referencë: Libri i rregulloreve Institucionale, "Mbi vlerësimin e studentit", Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcaktonte qartë të gjitha kriteret specifike të nevojshme për studentët si: pranimi, ndjekja e studimeve përgjate vitit akademik, afati i studimeve, transferimi i tyre. Të gjitha rregulloret në lidhje me transferimin e studentëve nga një program studimi në një tjetër brenda institucionit, dhe transferimi i studentëve nga një program studimi të një universiteti tjetër në një program studimi të KU IKT u bëheshin të ditura studentëve ndërmjet faqes web dhe Drejtuesit të departamentit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" janë përgatitur sipas një formati standart dhe integrojnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e lëndës; • Ngarkesën e lëndës në kredite dhe në orë; • Semestrin kur zhvillohet lënda; • Përshkrimin dhe objektivat e lëndës; • Rezultatet dhe kompetencat e mësimi; • Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; • Detyrimet e lëndës; • Laboratorët e parashikuar; • Literaturën bazë; • Literaturën ndihmëse; • Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; • Përmbajtjen e temave të kursit. <p>GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përmbajnë pothuajse gjithë elementët e nevojshëm për tu pasqyruar në to dhe se ka një përputhje të mirë me profilin e propozuar.</p> <p><i>Referencë: Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit nuk ka ndryshuar, kjo për arsye pasi pritej diplomimi i brezit të parë të studentëve me qëllim edhe marrjes së një opinioni nga tregu i punës.</p> <p>Departamenti në rregulloren e tij e kishte të përcaktuar qartë mënyrën e propozimit të ndryshimeve të programit të studimit dhe të përditësimit të syllabuseve përkatëse. Meqenëse jemi brenda afatit 5-vjeçar të</p>

	përditësimin nuk janë për momentin të nevojshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit është e strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e studentëve ka një ekuivalencë të matur në kredite sipas sistemit European të transferimit të krediteve ECTS, çdo semester organizohet në 30 kredite në një total prej 180 kreditesh për programin e studimit. Ndarja dhe raporti i orëve për secilin zë në kategoritë klasike të mesimdhënies është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës. Zhvillimi i praktikave profesionale parashikohej të realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucionesh e subjektsh të tjera si shtetërore ashtu edhe private. Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes këtij procesi për të mundur angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal nga ana e tyre. Gjithashtu, praktikat (sidomos të vitit të fundit) shikohen edhe si një mundësi për t'u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të inicuar punësimin e tyre të ardhshëm.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI janë vlerësuar shumë pozitivisht në disa projekte që kanë marrë pjesë dhe kjo është përdorur si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafëruara me programe të ngjashme ndërkombëtare. Studentët e Departamentit të Inxhinierisë Software janë pranuar me sukses si studentë të transferuar në shkollat më të mira inxhinierike, në universitete amerikane. Nga plani mësimor i paraqitur rezultojnë 1848 orë mësimore në auditor, I ndarë në:

	<ul style="list-style-type: none"> - 864 orë leksione - 208 orë seminare - 316 orë ushtrime - 306 orë laboratore - 34 orë projekte - 120 orë praktike - 150 orë teza <p>Raporti Teori (leksion) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt prof) rezulton 864 ore/984 ore, ose afërsisht 1:1</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI.</p> <p>Studentët e Departamentit të Inxhinierisë Software kanë përfunduar programet e mobilitetit në Universitete si Mevlana Turqi, Finland, Portugali etj., ku gjithmonë është arritur një përputhshmëri midis programeve të studimit të KU IKT-ë me institucionin pritës (universitetin e huaj).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve nuk kanë ndryshuar ato janë bashkëkohore dhe brenda afatit të tyre 5-vjeçar.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI garanton përfitim të njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Programi i studimit përfshin lëndë si “Hyrje në Ekonomi” në mënyrë që studentët të përftojnë edhe njohuri që mund t’i ndihmojnë në nismat e tyre të mëvonshme në fushën e sipërmarrjes.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve të Inxhinierisë Software në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë departamenti në vitin 2016 rezulton që pritshmëria e lartë e punësimit të studentëve që do të diplomohen në këtë vit akademik.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti është në pritje të diplomimit të brezit të parë të studenteve dhe më pasë në bashkëpunim edhe me kompanitë do të diskutojë për kërkesat specifike. Këto kërkesa do të diskutohen gjerësisht me Këshillin e programit të studimit dhe më pas do të kalojnë për miratim në Departament dhe Senat Akademik.</p> <p>Procedura është e qartë dhe e realizueshme duke marrë parasysh faktin e përdorimit të një programi studimi të ngjashëm me universitete</p>

	amerikano- veriore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoj se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI është mbuluar në masë më të madhe, rreth 90%, me staf akademik më së paku gradën shkencore Doktor. Konkretisht:</p> <p>GJITHSEJ për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim 22 pedagogë nga të cilët 19 PAE dhe 3 PAK (86% / 14%)</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof.Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>3 Prof.As.Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>8 Dr/PhD</td> <td>2 Dr</td> </tr> <tr> <td>1 Msc (Dr ne process)</td> <td></td> </tr> <tr> <td>6 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> </tbody> </table> <p>GJITHSEJ për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim 20 pedagogë nga të cilët 19 PAE dhe 1 PAK (95% / 5%):</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2 Prof. Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>2 Prof.As.Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>7 Dr/PhD</td> <td>1 Dr</td> </tr> <tr> <td>1 Msc (Dr ne proces)</td> <td></td> </tr> <tr> <td>7 Msc</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>GJITHSEJ për vitin akademik 2017 - 2018 kanë dhënë mësim 15 pedagogë nga të cilët 14 PAE (dhe 1 PAK 93% / 7%).</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof. Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>2 Prof.As.Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>2 Dr/PhD</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof.Dr		3 Prof.As.Dr		8 Dr/PhD	2 Dr	1 Msc (Dr ne process)		6 Msc	1 Msc	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	2 Prof. Dr		2 Prof.As.Dr		7 Dr/PhD	1 Dr	1 Msc (Dr ne proces)		7 Msc		<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Dr		2 Prof.As.Dr		2 Dr/PhD	
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																																
1 Prof.Dr																																	
3 Prof.As.Dr																																	
8 Dr/PhD	2 Dr																																
1 Msc (Dr ne process)																																	
6 Msc	1 Msc																																
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																																
2 Prof. Dr																																	
2 Prof.As.Dr																																	
7 Dr/PhD	1 Dr																																
1 Msc (Dr ne proces)																																	
7 Msc																																	
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																																
1 Prof. Dr																																	
2 Prof.As.Dr																																	
2 Dr/PhD																																	

		2 Msc (Dr ne proces)		
		7 Msc	1 Msc	
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në ofrimin e programit të studimit ka kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit. Para se të punësohet një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, publikohet një lajmërim zyrtar në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit të punës; atëherë aplikimet filtrohen dhe përgatitet një listë e shkurtër bazuar në kualifikimet përkatëse; aplikantët e përzgjedhur janë të ftuar në universitet për një leksion të hapur dhe pas një vlerësimi të aplikimit nga Komiteti Shkencor i Departamentit, kandidati i përzgjedhur punësohet.</p> <p>GVJ vëren një ndryshim të shpeshtë i stafit ndër vite.</p>			
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>Bazuar në CV e stafit akademik, niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikimet e moduleve të tij.</p> <p>Lektorët punojnë në fushat e kërkimit që përputhen me konceptet e mësuara në programin e studimit bachelor dhe ato përfshijnë elemente të fushës të tyre të kërkimit në lëndë.</p>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Departamenti i Inxhinierisë Software angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit. Për këtë departamenti ushtron një rol të veçantë për ekuilibrimin e ngarkesës së personelit në funksion të elementëve të ndryshëm përbërës të programit të studimit.</p> <p>Duke qenë se numri i studentëve është relativisht i ulët, personeli akademik dhe ai kërkimor efektiv është më se i mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p>Duhet theksuar fakti që praktikës profesionale i jepet një peshë e veçantë në formimin që ofron programi i studimit.</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor për zhvillimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore, në kuadër të ofrimit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe TI. Në varësi të numrit të orëve laboratorike, janë punësuar 2 asistentë laborator.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve. Institucioni demonstron vullnet në sigurimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mjedisit të nxënies. KU IKT përdor metodologji inovative të mësimdhënies për të rritur eksperiencat pozitive të nxënies për studentët e tij.</p> <p>KU IKT vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie dhe ka bërë përpjekje për të zhvilluar mënyra krijuese të mësimdhënies.</p> <p>Në fushën e mësimdhënies dhe nxënies jepen vazhdimisht aktivitete trajnuese, te cilat përdoren sipas nevojave të secilit Departament.</p> <p><i>Referencë: Rregulloreve Institucionale, Rregullore institucionale e KU IKT 2016.pdf, fq6-8, Rregullore e Fakultetit të Inxhinierise shqipang.pdf, fq 10-11.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur qendrën NJSBC e cila merr pjesë aktive në vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative të institucionit nëpërmjet procedurave të përcaktuara qartë në Statutin e KU IKT dhe në Rregulloren e vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë. Këto procedura konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryerja në mënyrë të rregullt e vlerësimit të personelit akademik nëpërmjet plotësimit të një pyetsori nga ana e studentëve për çdo lëndë të zhvilluar. • Dëgjimi i shpjegimit të lëndëve në auditor nga Dekani apo Përgjegjësi përkatës i Departamentit • Kryerja e auditimeve periodike në çdo njësi akademike dhe administrative të Universitetit nga Grupi i Auditit të Brendshëm • Zhvillimi në një bazë periodike i seminareve informuese dhe trajnuese me stafin e institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart sigurimi i cilësisë. • Tërheqja e mendimeve të studentëve për mënyrën e zhvillimit të praktikës profesionale.

	<ul style="list-style-type: none"> Përpunimi i gjithë informacionit në lidhje me vlerësimin e studentëve në elementët e ndryshëm përbërës të programit të studimit. <p><i>Referencë: DVV, Dok "Organizimi dhe funksionimi i NJSBC"</i></p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në rregulloren dhe statutin e KU IKT, institucioni garanton pjesëmarrjen e studenteve në vlerësimin periodik të metodës së mësimdhënies dhe vlerësimin e kompetencave. Çdo semestër studentët plotësojnë një pyetësor anonim ku vlerësojnë performancën e pedagogëve. Plotësimi i pyetësorit fillon një muaj para provimeve finale. Kërkesat e studentëve për lëndët me zgjedhje vlerësohen nga Departamenti çdo semestër.</p> <p>Raporti i përgjithshëm i vihet në dispozicion të departamentit dhe secilit pedagog duke ruajtur anonimatin.</p> <p><i>Referencë: DVV, Dok "Organizimi dhe funksionimi i NJSBC"</i></p>								
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC kryen analizimin e të dhënave për çdo lëndë dhe pedagog dhe del me rekomandimet përkatëse për Rektorin. Nëpërmjet mbledhjeve të Senatit, Rektori siguron që rekomandimet e NJSBC-së në lidhje me përmirësimin e procesit të mësimdhënies të zbatohen në nivel Fakulteti dhe Departamenti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe u jepet studentëve nëpërmjet kordinatorit të programit të studimit.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e ndërgjegjesimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ mbi rëndësinë e përvetësimit të kulturës së cilësisë nga çdo njësi në KU IKT, NJSBC zhvillon në një bazë periodike seminare informuese dhe trajnuese me stafin e institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart siguri i cilësisë në përgjithësi dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë në veçanti.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.2</p> <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit perfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimin, projekteve, detyrave, praktikave, seminarëve dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të pjesës teorike dhe gjysma e orëve javore për pjesën e aplikimit, punës laboratorike, projekteve dhe punimeve të tjera. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme;</p>

	provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodën e vlerësimit janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, koleqiumet, kuizet, projektet, projektet semestrale, pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik monitoronte me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpigjet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. Departamenti përdorte sistemin e këshillimit, ku studentët e viteve më lartë punojnë së bashku me studentët e vitit të pare dhe të dytë në lëndët ku ata hasin vështirësi. Departamenti ka punësuar asistentë lektorë për të ndihmuar studentët që hasin probleme të caktuara.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni demonstron se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe pas një vlerësimi lejohen përditësimet e metodave të mësimdhënies bazuar në kërkesën e lektorëve të lëndës. Çdo lektor inkurajohet të vëzhgojë kërkesat e tregut të punës dhe të implementojë mënyra të reja në mësimdhënie. Përditësimet duhet të jenë në përputhje me a) rezultatet e nxënësve, b) praktikën më të mira në universitetet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare dhe c) kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet mund të përfshijnë riorganizimin e orëve laboratorike dhe të seminareve. Gjithashtu institucioni duhet të bëjë përpjekje për mbështetjen në përditësimin e bazës laboratorike me laboratore më bashkëkohore për të ardhur më afër përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në mesimdhënie dhe temave laboratorike.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mesimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personeli akademik jashtë departamentit të Inxhinierisë Software. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie është kompetent në njohuritë dhe konceptet e shpjegimit duke përdorur metoda të ndryshme sipas temave. Metodën e mesimdhënies në Inxhinierinë Kompjuterike dhe TI përfshijnë leksionet, seminarët, projektet dhe praktikën laboratorike. Një metodë e drejtpërdrejtë për të siguruar kompetencat e lektorit është kontrolli nëse plani mësimor i përgatitur përputhet me brendinë e ofruar nga institucionet ndërkombëtare. Personeli PAE i departamentit duhet të marrë më shumë peshë në programin e studimit në fjalë. Institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje për qendrueshmërinë e stafit me kohë të plotë.
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në	Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mesimdhënies me anë të implimentimit të Pyetësorve mbi Vlerësimin e Lektorit të Lëndës i cili është një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mesimdhënies. Ky pyetësor mbahet në bazë

këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	semestrare. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese. Nga takimi me studentet u konstatua se ky mekanizem kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Në përgjithësi, personeli akademik në punën e përditshme gjatë procesit mësimor, synon të kalojë nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësimor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj. Përmes këtyre transformimeve synon të nxiten dhe zhvillohen cilësi si: a) kreativiteti; b) puna në grup dhe komunikimi i ndërsjellë; c) ndërgjegjësimi dhe marrja e përgjegjësisë; ç) individualiteti; d) zhvillimin i imagjinatës krijuese dh) zhvillimi i iniciativës për të vepruar; e) Të shprehurit korrekt me shkrim dhe me gojë.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në diskutim edhe me pedagogët, GVJ konstaton se mësimdhënia në KU IKT orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit dhe zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambjent të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenare të jetës reale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga të dhënat e RVB dhe vizita në institucion konstatohet se KU IKT-së zotëron hapësira jo plotësisht të mjaftueshme nga sasia student për m ² , raporti është 2297 m ² /760 student. në përgjithësi ambjentet janë bashkëkohore, si: laboratorë, klasa, zyra, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë, internet, etj. GVJ thekson se për raportin e studenteve të regjistruar hapsira është jo plotësisht e mjaftueshme. <i>Referencë: DVV, Kontratat e qerase.pdf, Planimetrite.pdf, RVB</i>

<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ne përgjithësi sallat e përcaktuara për procesin e mesimor janë të pajisuara me pajisjet më moderne që përfshijnë projektorët, tabela, kompjuterat në laboratorët kompjuterikë dhe instrumentat eksperimentalë për laboratorin e fizikes, kimise, internet wireless në të gjithë universitetin për të gjithë studentët dhe stafin dhe një bibliotekë e bollshme.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët duke përfshirë edhe akses në bibliotekë, internet wireless pa limit, përdorimin e laboreve në orare të zgjatura.</p> <p>Personeli akademik dhe studentët në përgjithësi ishin të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin me sukses të programit mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura e nevojshme është e disponueshme në formën libri në bibliotekën e KU IKT. Në fillim të çdo semestri të gjithë lektorët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme, ju kërkohet të përcaktojnë librat që planifikojnë të përdorin në mësim. Kërkesat e tyre paraqiten në Departament dhe më pas librat janë të disponueshëm edhe për studentët në bibliotekë. Studentët gjithashtu kanë akses edhe në formën software të materialeve të siguruara nga personeli akademik në platformën online të ndërtuar nga vete institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizita në institucion, biblioteka e IKT ka rreth 3000 tituj librash gjithsej, me 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2980 tituj në anglisht, dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databasin e bibliotekës dhe çdokush në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë në gjëndje në Bibliotekën e KU IKT.</p> <p>Biblioteka kishte të instaluar edhe 6 kompjutera që janë pjesë e integruar e bibliotekës dhe i ndihmon studentët të kenë qasje në internet, në lidhje me librat, burimet elektronike të disponueshëm në bibliotekë, ndërsa marrin ndihmë të drejtpërdrejtë nga punonjësja e bibliotekës mbi mënyrën e arritjes dhe të përdorimit të burimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB takimi me drejtuesin e bibliotekës rezultoi se gjatë vitit akademik 2016-2017 u shtua një shërbim shtesë studentëve dhe anëtarëve të stafit akademik, krijimi i Bibliotekës Virtuale të KU IKT, e cila siguron qasje në stafin akademik dhe studentët në tekstet shkollore.</p> <p>Ky akses u krijua sipas marrveshjes që KU IKT kishte firmosur me shtëpinë botuese McGraw-Hill Education, Angli. Database i bibliotekës Virtuale mund të konsultohen nga faqja e internetit e bibliotekës së IKT, ndërsa i gjithë stafi dhe student e IKT mund të kenë qasje në burimet e tyre elektronike në çdo kohë.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të</p>	<p>Të gjithë studentët dhe veçanërisht studentët e Inxhinierisë Kompjuterike dhe TI kanë akses në labore (kompjuterike, elektronike, fizikës, kimisë etj.) për detyrat e lëndëve dhe tezat e diplomës. Laboretet kompjuterike përdoren për simulimet në shkallë</p>

vazhdueshme nga studentët.	të lartë pasi ofrojnë fuqi të lartë llogaritëse. Labororet elektronike përdoren për projektet dhe detyrat që kanë të bëjnë më shumë me pjesën mekanike, sistemet e kontrollit dhe robotikën.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platforma “University Management System, CIT E-Learning system” mundëson komunikim të drejtpërdrejtë mes lektorëve dhe studentëve, mundëson publikimin e shënimeve të mësimit, publikimin e detyrave dhe projekteve, mundëson dorëzimin e drejtpërdrejtë të përgjigjeve të studentëve për vlerësim. Institucioni ka siguruar licensën e shërbimeve të Microsoftit dhe Google për të gjithë personelin dhe studentët dhe ofron seksione trajnimi për personelin për përdorimin e këtyre shërbimeve.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik përdor Sistemin e brendshëm të ndërtuar nga vet stafi i departamenti për të shënuar dhe për të ndjekur pjesëmarrjen në mësim të studentëve, për të shfaqur notat e detyrave dhe provimeve dhe për të vëzhguar performancën e studentëve. Koordinatori dhe keshilluesit e studentëve e përdorin këtë sistem për të monitoruar performancën e përgjithshme të secilit student në çdo program studimi.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Departamenti, nëpërmjet kordinatorit të programit të studimit njofton me email, duke u sugjeruar studentëve fushat e mundshme dhe temat e diplomimit, si dhe pedagogët udhëheqës shkencorë përkatës, ku përcaktohet edhe afati i paraqitjes së kërkesës dhe formularit specifik të diplomimit, i cili pasi plotësohet nga studenti, me asistencën e regjistrarit dhe të tutorit akademik, i paraqitet për miratim Koordinatorit të Programit/Përgjegjësit të Departamentit.</p> <p>Me marrjen e miratimit studenti fillon punën për punimin e tij të diplomës, gjatë të cillës ai mbikqyret dhe asistohet nga udhëheqësi i miratuar shkencor, i cili ndihmon studentin në çdo fazë të këtij punimi, lidhur me: marrjen, analizën e të dhënave, nxjerrjen e konkluzioneve dhe ofrimin e rekomandimeve përfundimtare të punimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Institucioni konform kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka themeluar në vitin 2013 njësinë e quajtur NjSBC. Kjo njësi është e organizuar në mënyrë të atillë, ku brenda saj ka përfaqësues të të dy njësive kryesore. Përfaqësimi i tyre i shërben bashkërendimit të punëve mes njësisë dhe fakulteteve e më pas departamenteve.</p> <p>KU IKT-së duke qenë një institucion i vogël e ka të organizuar NjSBC në rang institucioni dhe fakultetesh. Parashikohet që me rritjen e numrit të studentëve do të riorganizohet duke u shtrirë edhe nëpër</p>

	departamente.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e vete universitetit. Duke pasur parasysh që gjuha e mësimdhënies është në gjuhë angleze dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhurnime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat ndërkombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marrë pjesë në leksionet e mbajtur nga aplikantët. Vlen të përmendet si faktor jo shumë pozitiv, fakti i ndryshimit të shpeshtë në vitet e fundit të stafit me kohë të plotë.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Institucioni deshmon se ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mesimdhënies me qëllim rritjen e cilësisë. Në këtë kuadër institucioni ka përqafuar idenë e pjesëmarrjes së stafit në konferenca të ndryshme por edhe në shkëmbimin e eksperiencave me universitete të rajonit si dhe ato që janë pjesë e rrjeteve CEEPUS dhe Erasmus+ projekte të cilat i ka realizuar me Universitetin Orada të Rumanisë dhe disa universitete në Hungari.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Megjithëse KU IKT nuk i ofront të tre ciklet e studimit ai demonstron një interes të veçantë për kualifikim e personelit akademik Master i Shkencave me kohë të plotë. Institucioni është aktiv edhe në programet e shkëmbimit të stafit akademik në mënyrë që të rriten kualifikimet e tyre nga ana profesionale si dhe në trajnime të ndryshme. Gjithashtu konstatohet edhe mbështetja financiare në kualifikimin e stafit akademik për departamentin përkates.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	GVJ bazuar në RVB dhe materialet në dosje konstaton se, institucioni për rritjen e performacës së stafit akademi në kuadër të programit Erasmus+ janë nëshkruar ndërmjet KU IKT dhe një sërë universiteteve përëndimore një numër shumë i madh marrëveshjesh, prej të cilave do të përfitojnë studentët dhe stafi akademik. Marrëveshjet janë afatgjata dhe kanë nisur nga viti 2018 dhe do të zgjasin për një periudhë tri vjeçare, deri në 2021. Rezultatet e këtyre marrëveshjeve priten të sjellin një përmirësim të aftësive të stafit akademik të ri.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik i institucionit dhe personeli ndihmës akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin caktimin e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë	Kyesisht metodat e përdorura nga ana institucionit ishin tradicionale, por po bëheshin përpjeqe që krahas tyre të futeshin edhe metodat bashkëkohore duke vendosur studentin në qendër të mësimdhënies. Synohet që mësimdhënia të orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga

përgjegjëse.	njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambjent të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenare reale të jetës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ bazuar në materialet në dosjen e vetëvlerësimit konstaton se institucioni ka hartuar rregullore për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive personale të studentëve spas tre dokumentave si mëposhte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e programit të Studimit • Rregullorja “Mbi Vlerësimin e Studentit” që gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale • Rregullore e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë <p>Studentet informoheshin rregullisht për mënyrën e testimit dhe të vlerësimit. Për këtë çdo pedagog, në përputhje me natyrën e lëndës dhe rëndësinë që ka aspekti aplikativ, përcakton ndarjen/peshën e secilit komponent në vlerësimin përfundimtar dhe i prezantohen studentit me praqitjen e syllabusit të lëndës.</p>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga takimi me studentet dhe materialet e raportuara u konstatua se studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale, si dhe aftësitë profesionale dhe kërkimore, të parashikuara në plan-programin e lëndës nga drejtuesi i lëndës. Të gjitha detajet për të gjitha lëndët e ofruara nga Departamenti i Inxhinierisë Software për programin e studimit në fjalë publikoheshin rregullisht në internet në faqen zyrtare të institucionit dhe jepeshin nga kordinatori i programit të studimit në fillim të vitit akademik apo në fillim të secilit semestër.</p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>GVJ konstoj se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Syllabusi përcakton qartë mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në RVB dhe takimin me studentet GVJ konstaton se: vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studenteve realizohet gjatë gjithë vitit akademik i shpërndarë sipas peshës që zë secili element i përcaktuar në Programin e Lëndës.</p> <p>KU IKT kryesisht ka të përcaktuar një formë të përgjithshme të kontrollit të njohurive e cila gjendet në rregulloren “Vlerësimi i Studentit” (Student Evaluation).</p> <p>Kështu forma e përgjithshme e vlerësimit është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</i> - 10% • <i>Plotësimi i detyrimeve (kuizeve, studimeve të rastit, detyrave/projekteve të kursit)</i> - 20-30% • <i>Provimi i Ndërmjetëm</i> - 25-35% • <i>Provimi përfundimtar</i> - 30-40%
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk përdor metoda apo sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Kjo pasi institucioni mendon dhe vlerëson se përveç pjesë (pyetjeve) të testimit që përmbajnë aleternativa, studentët duhet të jenë të aftë të analizojnë dhe t’u përgjigjen një pjesë të pyetjeve brenda vlerësimit, me shkrim dhe në mënyrë subjektive të zgjeruar. Megjithatë nëse në të ardhmen, format e vlerësimit dhe testimit do të vendosen prej organeve kolegjiale që të jenë vetëm me alternativa, atëherë institucioni do të marrë masat për aplikimin e një softueri të tillë.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Provimet realizohen nga titullarët e lëndëve/moduleve ose edhe të ndihmuar nga një asistent lektor (co-teacher) nëse lënda/moduli ofrohet prej 2 pedagogëve.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Vlerësimi bëhet mbi bazën e konfidencialitetit, si një proces vlerësimi anonim, ku të gjitha testet/tezat e provimit janë të sekretuara dhe të shoqëruara me komentet përkatëse të vlerësimit, në mënyrë që studenti të jetë sa më i qartë dhe i vetëdijshëm për gabimet e pasaktësitë e tij. Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet, midis të tjerave nëpërmjet 2 provimeve, të cilët realizohen vetëm me shkrim: njërit provim të ndërmjetëm (Midterm Exam) dhe tjetrit atij përfundimtar (Final Exam).
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i aftësive dhe kompetencave shoqërohet me komente ose reagime (nëse është e nevojshme) dhe përfshin rekomandime për procesin mësimor në mënyrë që t’i ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Vlerësimi i bazuar në koment dhe vlerësim kryesisht sigurohet në lëndë që janë të bazuara në projekt dhe studentët marrin përshtypje për përmirësim nga mbikëqyrësi dhe komisioni i vlerësimit.

	<i>Referencë: Rregullore e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë, Mbi vlerësimin e studentit” (Student Evaluation).</i>			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën dhe nuk e tolerojnë kopjimin në provime dhe detyra. Lektorët vlerësojnë me kujdes situatat e dyshimta dhe ndërmarrin veprime në vlerësimin e materialit të paraqitur që mbart elemente kopjimi.</p> <p>Gjithashtu tek programi i çdo lënde bëhet përkrahimi i plagjiaturës me qëllim shmangien e saj nga studentët. Plagjiatura përcaktohet si përdorimi i punës, ideve apo fjalëve të dikujt tjetër. Mund të përfshijë elementet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopjimi e punës së një personi tjetër. • Shkarkim, huamarrja apo blerja nga interneti, e projekteve, punimeve apo detyrave të kursit. • Përdorimi i punës së dikujt tjetër. • Paraqitja e rrejtshme e burimeve që janë përdorur. • Lejimi i një personi tjetër për të bërë punën akademike. <p>Institucioni nuk rezulton të ketë mjete efikase në kontrollin e plagjiaturës.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB</i></p>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Rezultatet e kontrollit të aftësive dhe aftësive profesionale bazohen në merita dhe dërgohen me kohë, bazuar në përcaktimet në rregulloret përkatëse. Në KU IKT provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare vlerësohen në mënyrë anonime duke bërë të mundur një vlerësim anonim të provimeve të studentëve. Kjo tregon një perspektivë institucionale për të qenë objektiv në vlerësim.</p>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Vlerësimi i studentëve në KU IKT bëhet në bazë të sistemit Amerikan të notave dhe krediteve ECTS.</p> <p>Studentët që kanë ankime në lidhje me notën e marrë mund të aplikojnë për ankesë për notë sipas rregulloreve të institucionit e përshkruar në rregulloren e studimit dhe guidën e studentit.</p>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Procedura e ankimimit dhe shqyrtimi i saj është shtjelluar në mënyrë të detajuar edhe në Guidën e studentit faqe 10-12, ajo përcakton të gjitha etapat që kalon një ankimim deri në zbardhjen e një vendimi përfundimtar. Të gjitha ankimimet dhe procedura e ndjekura me pasë arkivohen dhe janë të aksesueshme nga NJSBC.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 33

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ mendon se programi Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe IT”, si program studimi i Ciklit të Parë, është ndërtuar me qëllim që të mundësojë formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore; si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit që ata të integrohen më së miri në tregun e punës.</p> <p>Qëllimi i këtij programi studimi është të sigurojë përgatitjen e specialistëve në fushën e inxhinierisë kompjuterike bazuar në programet më të përparuara të kohës. Programi i studimit synon që tu jap studentëve konceptet themelore të inxhinierisë dhe njohjes së veçorive kryesore të përpunimit të sistemeve të informacionit, ndërtimit hardware dhe software të tyre.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB, Rregullore e Programit të Studimit BSc në Inxhinieri Kompjuterike dhe IT,</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit (përfshirë gjuhën e huaj).</p> <p>Në kurrikulën e programit të studimit Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT, studentët mund të zgjedhin dy lëndë në kategorinë ndërdisiplinore: Ethics (Etika), Academic Reading and Writing I and II (Lexim dhe Shkrim Akademik I dhe II); por kanë edhe mundësi të lëndëve me zgjedhje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Introduction to Psychology (Hyrje në Psikologji) ose - Introduction to Research Methods (Hyrje në Metodat e Kërkimit)
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit, Dok[Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe IT, fq5], konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimesi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe raportet rezultojnë se në javën e fundit të programit të lëndës, pedagogu bën një përsëritjeje njohurish dhe konceptesh më thelbësore, e cila orienton studentët mbi strukturën e provimit përfundimtar, si një nga elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara nga ana e studentit gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, duke vënë theksin në analizën dhe të kuptuarit e kompetencave të fituara nga lënda/moduli.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Bazuar në RVB dhe DVV, dok [Raporteve te vetvleresimit te stafit akademik 2018-2019-Shembuj.pdf] personeli akademik zhvillon orë mësimore jo i vetëm në auditor, por në bashkëpunim me industrinë,</p>

<p>teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>bizneset dhe sipërmarrjet shumë orë mësimore janë kthyer në leksione të hapura në të cilat kanë marrë pjesë specialistë, emra të njohur të fushës si dhe të ftuar të ndryshëm që kanë ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia kryhet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që t'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. Studentët kanë një laborator të dedikuar Elektronike për të zhvilluar projektet e tyre dhe studentët e vitit të tretë e kanë përdorur në mënyrë të mjaftueshme në fushën e robotikës.</p> <p>GVJ e vizitoi këtë Laborator</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetë vlerësimit KU IKT demonstron se ofron asistencë teknike dhe logjistike studentëve dhe kërkuesve, të cilët inkurajohen vazhdimisht të eksplorojnë tema të ndryshme kërkimore aktuale, nëpërmjet ofrimit të logjistikës laboratorike, apo mbështetjes për pjesëmarrjen e studiuesve të rinj në aktivitete kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në mbështetje të studentëve ka patur mbështetje financiare për organizimin e konferencave studentore, akademive verore, start up-eve si dhe iniciativave të prezantuara prej tyre. Në këtë drejtim janë mbështetur edhe klubet studentore të cilat janë aktivizuar dhe kanë dhënë një kontribut në pasurimin e jetës studentore ndër vite, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Enrichment Clases • CIT Robotic Club • Business Club • Charity Club • Gaming Club • Sports Club • Books and Movie Club <p>Në kuadër të këtyre klubeve aktivitete të ndryshme janë sponsorizuar për të pasuruar jetën studentore si dhe për t'i përfshirë ata në kompeticione brenda e jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik krijon një atmosferë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara dhe shkencore dhe mbështetje ndaj studentëve. Studentët Bachelor ishin përfshirë në projekte kërkimore nën mbikëqyrjen e personelit akademik të departamentit në kuadër të projekteve dhe punimeve shkencore.</p> <p><i>Referencë: Katalogu i veprimtarive të KU "IKT" 2018-2019 dhe 2019-2020, Studentet pjesemarres ne Ceepus.pdf, Studentet pjesemarres ne Ceepus.pdf</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Institucioni dëshmon mbështetjen dhe sponsorizimin e aktiviteteve shkencore në dobi të studentëve për këtë institucioni kishte ndërmarrë përsipër të mbështesë dhe inkurajojë aktivitete të tilla si: 1) Konferenca Studentore: Mbi Ekonominë, Financën, Biznesin dhe Shkencat Sociale – SCE 2019, e organizuar prej Universitetit Epoka dhe në bashkëpunim</p>

	me KU "IKT" (CIT) më 24 qershor 2019; 2) Open Summer Academy: Go Digital – U organizua prej KU IKT gjatë periudhës 08/07/2019-13/07/2019. 3) Blackhat 2.0 – Një organizim i rrallë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kibernetikës ku KU IKT në këtë organizim në fushën e sigurisë kibernetike si dhe vetëdijes për rëndësinë e saj u zhvillua përmes kontributit të KU "IKT" dhe partnerëve të tjerë, për t'u ardhur në ndihmë të rinjve si dhe studentëve që e shohin të ardhmen e tyre në këtë fushë; 4) "Open Lecture Partnerships Between Startups and Corporations" Aktivitet që ishin realizuar në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm midis Raiffeisen Bank Shqipëri dhe KU IKT, si një cikël leksionesh të hapura ku prezantuan përfaqësues të biznesit, menaxhimit, komunikimit mediatik e digjital, si dhe start up-ëve.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit vërehet se personeli akademik kombinon format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. Departamenti i Inxhinierisë Software ka përdorur mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e mobilitetit CEEPUS dhe Erasmus, që bëjnë të mundur vizita afatshkurtra të realizuara nga personeli akademik dhe gjatë këtyre programeve të lëvizshmërisë studentët kanë përfituar nga metodat e ndryshme të mësimdhënies që kanë ndjekur në universitet të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit institucioni ka miratuar dhe ndjek procedurën për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja "Mbi shkrimin e tezës së diplomës", që gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale. • Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë të Studimeve. • Rregullorja e Programit të Studimit. • Manuali i Punimit të Temës së Diplomës. Procedura është konform normave ligjore dhe të cilësisë, ajo behet publike dhe studentët informohen përgjatë vitit të 3-të nga ana e kordinatorit të programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së	Bazuar në "Rregullorja e Programit të Studimit" dhe "Manuali i Punimit të Temës së Diplomës", departamenti organizon një takim për të konsultuar tema të ndryshme që mund të shërbejnë si referim për studentët që do të diplomohen në përfundim vitit të tretë. Secili anëtar i stafit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, ofron propozime konkrete për temat e diplomimit, të cilat ai / ajo është i gatshëm të mbikëqyrë, duke bërë

diplomës.	të mundur krijimin e një banke me tema tezash. Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga departamenti përkatës me formularin e aplikimit për tezën së bashku me një listë të mbikëqyrësve të mundshëm të tezës dhe temat e propozuara. Studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke konsultuar paraprakisht një mbikëqyrës të mundshëm dhe e paraqet atë brenda javës së tetë të semestrit të parë. Në rast të mos përmbushjes së afatit, studenti mbron tezën e tij në sezonin e ardhshëm. Shqyrtimi i aplikimeve bëhet nga drejtuesi i departamenti, i cili i dërgon propozimet për miratim Këshillit të Fakultetit. i gjithë procesi mbikëqyret nga Dekani.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Institucioni nuk aplikon provimin final por mbrojtjen e temave të diplomave. Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e institucionit “Komisioni i posaçëm” i cili ngrihet me propozim të Departamentit dhe miratohet nga Dekani vlerëson punimin e diplomës duke i mbështetur në: <ul style="list-style-type: none"> • Tema dhe çështjet shkencore të trajtuara • Metodologjia e punimit dhe prurje te reja • Burimet dhe puna në terren (jo domosdoshmerisht) Procedura është konform normave ligjore e mbështetur në rregullore të bërë publike dhe është plotësisht objektive.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjere, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në “Rregullorja e Programit të Studimit” dhe “Manuali i Punimit të Temës së Diplomës”, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbeshtetja në raste të caktuara mund të përfshijë edhe blerjen e mjeteve laboratorike, si në rastin e robotikes.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Bazuar në RVB rezultoni se udhëheqësi i tezës së diplomës i përcakton një problem të përshtatshëm studentit dhe më pas e çon atë: a) të kuptojë problemin, b) ndihmon për të identifikuar gjendjen e artit që është në dispozicion, c) për të përcaktuar një qasje për të zgjidhur problemin, ç) për të zgjidhur dhe raportuar në një mënyrë të përshtatshme. Mbikëqyrësi i tezës së diplomës vlerëson nëse teza mund të paraqitet para komisionit apo jo ai jep verdiktin përfundimtar.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Bazuar në “Rregulloren e programit të studimit”, nëni 5 përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të provimit final apo punimit të diplomës, në këtë program studimi të gjithë studentët marrin temë dhe mënyra e vlerësimit përcaktohet në mënyrë objektive mbështetur në rezultatet e arritura në përfundim të paraqitjes së punimit dhe mendimit të udhëheqësit të temës së

	diplomës.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në “Rregulloren e programit të studimit”, neni 8 studentët të cilët plotësojnë kërkesat e plotë të procedurës së diplomimit, si kërkesa për kredite ECTS, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Pas diplomimit “Sekretaria Mësimore” përgatit diplomën dhe suplementin e diplomës për studentët e diplomuar sipas afateve kohore dhe rregulloreve. Procedura konsiston në diplomat e studentëve për të gjitha programet e studimit regjistruhen në sistemin interaktiv dhe përgatiten sipas formateve të licencuara dhe të miratuara nga MASR. Të gjitha formatet e diplomës përfshijnë numrin serial të diplomës të dhënë nga autoritetet përkatëse që aprovojnë.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Çdo student në KU IKT paiset me Diplomen dhe Suplementin e Diplomës përkatëse ku raportohen shumë detaje të programeve të tyre përkatëse të studimit. Bashkë me këtë i jepet edhe një kopje e programit si dhe një listë notash.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave të direktivës së vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentor në të njëjtën mënyrë siç ishte gjatë periudhës së studimit. Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga institucione të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program	KU IKT ka në organikën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore [dok. 6, Organigrama]. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë

dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të angazhuar në programin e studimit. Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore. Dokument i pa azhornuar ishte vetëm CV e personelit e cila ishte dokument i dorëzuar në momentin e aplikimit fillestar si personel pranë KU IKT, modifikime të mëvonshëm të këtij dokumenti nuk paraqiteshin në dosje. Nga personeli shpjegohet se në dosje azhornohej dokumentacionet ligjore, ndërsa CV e azhornuar rruhet në format elektronik dhe nuk reflektohet në dosje (hard copy) për të mos rritur vëllimin e saj.			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	KU IKT, në Librin e Rregullores Institucionale [dok. 8, Rregullore Institucionale] ka të përcaktuar në Kapitullin VIII, Kreu I, procedurat e rekrutimit të stafit akademik.			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në përgatitjet e fillimit të çdo viti akademik, bazuar edhe në nevojat për plotësimin dhe mbulimin e programit të studimit me personel akademik të kualifikuar, Departamenti përkatës për programin e studimit harton një propozim drejtuar Këshillit të Fakultetit. Propozimi përmban të dhënat specifike të lëndës/moduleve/kualifikimeve që kërkohen dhe mënyrën e tyre të vlerësimit [dok. 52.1, rekrutimi – Hapja e një pozicioni të ri.]. Informacioni bëhet publik në faqen ueb të KU IKT [https://cit.edu.al/careers/]. Nga konsultimi i faqes zyrtare ueb të institucionit (dt. 15.06.202) rezultojnë të hapur tre shpallje për pozicione pune. Kriteret e personelit të kërkuar janë të qarta sikurse edhe impenjimi që kërkohet nëse punësohet. Vendet e shpallura janë dy për personel administrativ dhe një për personel akademik në Fakultetin e Inxhinierisë.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik janë publike sikurse edhe procedurat e vlerësimit janë të standardizuara dhe të bazuar në një skedë pikëzimit [dok. 52.2, Rekrutimi, tabela e vlerësimit]. Skeda e pikëzimit është efektive për vlerësimin e kandidatëve të mundshëm për pozicion akademik. Bazuar në Rregulloren Institucionale [dok. 8, Rregullore Institucionale], rekrutimi zhvillohet në dy faza, e para shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati. Faza e dytë përkon me intervistën e kandidatëve dhe vlerësimin e tyre përfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 39

<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>KU IKT ndodhet në godinën “Zayed Center” në Rr. Andon Zako Çajupi Nr. 6, Tiranë. I gjithë aktiviteti didaktik dhe administrativ për këtë program studimi zhvillohet në këtë godinë. Duke parë edhe numrin e studentëve relativisht jo të lartë për këtë program studimi (më pak se 40 student), [shih dok. Shënime në Vizitë], ambientet kanë të gjitha hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe realizimin e të gjithë aktivitetit didaktik dhe laboratorik të nevojshëm.</p> <p>Shfrytëzimi i ambienteve në orarin 09:00-18:00 për ciklin e parë të studimeve dhe në orarin 17:00-21:00 për ciklin e dytë tregon një menaxhim efikas të ambienteve në dispozicion.</p> <p>Ambientet kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin efektiv të të gjithë procesit didaktik.</p> <p>KU IKT ka venë në dispozicion të studentëve/stafit një bibliotekë me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si nga takimi me Rektorin dhe dy Zv. Rektorët, ashtu edhe me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit dhe pedagog të këtij institucioni u paraqit një panoramë e angazhimit të institucionit në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit.</p> <p>Mbështetja e Institucionit është pjesërisht në ndihmesë ekonomike për pjesëmarrje në konferenca (regjistrim, udhëtim etj.) ku u përmendën shembuj të stafit që kishte marrë pjesë në konferenca jashtë Shqipërisë me shpenzime të mbuluara nga institucioni.</p> <p>Edhe gjatë takimit me anëtar të stafit akademik u përsërit mbështetja e institucionit në pjesëmarrje në konferenca.</p> <p>Megjithatë mbështetja e institucionit e paraqitur nga stafi drejtues nuk përputhet me të dhënat financiare [dok. 26, Raport Institucional për MASR, përpiluar në Shtator 2019, faqe 38-40] ku treguesit financiar për vitin akademik 2018-2019 (të përfunduar) tregojnë shpenzime të ulëta (26,000 ALL) për kërkim shkencor dhe (0 ALL) për konferenca.</p> <p>Gjithashtu i ulët është edhe parashikimi për vitin akademik aktual (2019-2020) parashikohet një shpenzim në nivel institucioni rreth 100,000 All për kërkim shkencor dhe 150,000 All për konferenca, kjo në nivel institucioni.</p> <p>Ky dokument nuk është në përputhje me buxhetin e paraqitur sipas njësive kryesore [dok. 64, Buxheti sipas njësive kryesore], ku zëri i Kërkimit shkencor dhe konferenca për Fakultetin e Inxhinierisë është rreth 7000 €.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion grupi i RVJ kërkoi shpjegime rreth kësaj mospërputhjeje, dhe interpretimi ishte se dokumenti 26 më sipër është draft në fillim të vitit akademik përkatës dhe paraqet parashikim dhe jo realizim. Gjithsesi edhe ky shpjegim bie ndesh me datën e përpilimit, datë e cila është në fund të vitit akademik përkatës (analizon vitin akademik 2018-2019 dhe është përpiluar në Shtator 2019, pra nuk mund të jetë një parashikim për një vit që sapo është përmbyllur, por është</p>

	<p>realizimi i tij).</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit me GVB për këtë çështje u përmend fakti se gjatë këtij viti akademik vetëm një personel akademik ka bërë kërkesën për mbulim shpenzimi për pjesëmarrje në konferenca prandaj edhe shpenzimi është i ulët.</p> <p>Ndihmesa efektive e vërtetuar për kualifikimin e stafit është publikimi pa kosto në revistën e brendshme të institucionit.</p> <p>Nga vlerësimi në institucion, stafit akademik që janë në proces doktrate, u mundësohet një ulje e ngarkesës në institucion për të përgatitur përmbylljen e punimit doktoral, por gjithsesi pa cënuar aktivitetin didaktik. Kjo vërehet edhe në rregulloret dhe vendimet e brendshëm të institucionit [dok. 25, Vendimi i Senatit Akademik].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo vërehet edhe në trajnime të brendshëm të zhvilluara si dhe në miratimin e planit strategjik për “Life long Learning – LLL” [dok. 40, Miratimi i Planit Strategjik LLL].</p> <p>Institucioni, nëpërmjet edhe përdorimit të bibliotekës online motivon përdorimin dhe zgjerimin e njohurive didaktike dixhitale që janë në fokus të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Ku IKT ka të miratuar në Librin e Rregulloreve Institucionale [dok. 7, Libri i Rregulloreve Institucionale] procedurat dhe kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis stafit akademik.</p> <p>Nga ana procedurale përmbushen kriteret si dhe impenjimi i institucionit, por nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ka vend për përmirësime.</p> <p>Në veçanti, referuar tabelës 2 në RVB në lidhje me personelin akademik të “Departamenti i Inxhinierisë Softuerike”, përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” vihet re një angazhim i ulët i këtij stafi në këtë program studimi.</p> <p>Për më shumë detaje i referohemi tabelave 12.1, 12.2, 12.3 në RVB “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës” për tre vitet e fundit akademike vihet re se ngarkesa mësimore e lëndëve për programin e studimit është e shpërndarë sipas departamenteve si:</p> <p style="padding-left: 40px;">4/28 mbulohen nga “Software Engineering”</p> <p style="padding-left: 40px;">5/28 mbulohen nga “Business Administration”</p> <p style="padding-left: 40px;">8/28 mbulohen nga “Industrial Engineering”</p> <p style="padding-left: 40px;">6/28 mbulohen nga “CIRD Engineering”</p> <p style="padding-left: 40px;">5/28 mbulohen nga "Business Administration and IT"</p> <p>Pra rreth 14% e aktivitetit didaktik mbulohet nga personel PAE/PAK i departamentit përgjegjës për programin e studimit dhe dyfishi (28%) nga personeli i Departamentit “Industrial Engineering”.</p>

	Edhe pse personeli akademik i angazhuar ka formimin e kërkuar për programin e studimit, departamenti përgjegjës për programin e studimit duhet të ketë angazhim më të madh në formimin e studentëve të këtij profili.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se KU IKT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse.</p> <p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të planimetrisë së godinës ku KU IKT zhvillon aktivitetin në godinën “Zayed Center” në Rr. Andon Zako Çajupi Nr. 6, Tiranë. Ofron një sipërfaqe të përgjithshme prej 2297 m². Për numrin e studentëve, relativisht të ulët në tërësi dhe shfrytëzimi efikas i orareve, ambientet janë të përshtatshme për zhvillimin e këtij program studimi.</p> <p>Prania e ambienteve ndihmëse si bar-restoranti (vlerësuar si një ndihmë e madhe nga studentët) si dhe salla e konferencave, garantojnë ambientet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë akademike dhe jo vetëm pranë këtij institucioni.</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse.</p> <p>Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Edhe salla e konferencave me një kapacitet prej rreth 70 persona ishte e pajisur me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në dispozicion të procesit didaktik dhe jo vetëm.</p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Bazuar edhe në programin e studimit objekt e kësaj RVJ-je, “Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, laboratorët e nevojshëm janë kryesisht laborator të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Në Institucion u vizituan katër laboratorë informatike:</p> <p>Lab 1: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor;</p> <p>Lab 2: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor;</p> <p>Lab 3: Përmban 29 kompjutera + 1 video projektor;</p> <p>Lab 4: Përmban 29 kompjutera + 1 video projektor.</p> <p>Softuer të instaluar në këto laboratorë janë në përputhje me plan-</p>

	<p>programet e lëndëve dhe në funksion të formimit të përgjithshëm dhe specifik të studentëve të këtij program studimi.</p> <p>Në veçanti programe që lidhen me mësimdhënien specifike të këtij program studimi janë:</p> <p>Ambient Linux në dual boot me atë Microsoft Windows; MsSQL server; Ms Visual Studio; NetBeans; Octave; Wireshark; Bizagi Modeler & Express; Wamp Server etj.</p> <p>U vizitua edhe një laborator i fizikës/elektronikës i cili kishte pajisje matëse elektronike dhe borde zhvillimi (RasberyPI, Arduino dhe FPGA) të cilat përdoren nga studentët për projekte specifike në bashkëpunim me pedagogët e departamentit.</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni, sikurse përmendet edhe në Kriterin 3 më sipër, ka në dispozicion katër laborator informatike të pajisur me programe profesionale në funksion të aktivitetit didaktik dhe programeve të studimit që ofron.</p> <p>Nga vizita në institucion, na u konfirmua se laboratorët mund të aksesohen nga studentët edhe përtej orarit didaktik të lëndëve përkatëse dhe ti përdorin ato për punimin e detyrave/projekteve të kursit.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon. [dok. 44.a, 44.b, 44.c, 44.d 44.e, Marrëveshje Institucionale]</p> <p>Gjithashtu realizimi/vlerësimi i praktikave mësimore është i rregulluar me anë të manualit përkatës [dok. 14, Manuali i Praktikës Mësimore].</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, KU IKT disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 60m² të pajisur me një fond të konsiderueshëm librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme për rreth 30 student njëkohësisht që duan të shfrytëzojnë literaturën në kopje fizike. Gjithashtu ka edhe 6 PC për të konsultuar bibliotekën virtuale e cila ofrohet në bashkëpunimi me McGraw-Hill Education. [dok. 38, Dokumentacioni mbi bibliotekën].</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike kryesisht në gjuhën angleze. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe (rreth 20 tituj) nuk</p>

<p>mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>përbën pengesë për këtë institucionin dhe në veçanti për këtë program studimi pasi ai zhvillohet i gjithi në gjuhën angleze.</p> <p>Literatura e nevojshme për objektivat e këtij programin e studimit [dok. 57, Tekstet e literaturës mësimore] është e parashikuar në gjuhën angleze. Literatura bazë ose ajo ndihmëse për lëndët gjendet në librarinë fizike ose/dhe në atë virtuale.</p> <p>Gjetja e librave në gjuhën shqipe për këtë program studimi, duke qenë ai dinamik dhe në evolucion shumë të shpejtë në rang botëror, do të sillte literaturë të vjetërsuar për vetë kohën që një literaturë në këtë fushë kërkon që të përkthehet/përshtatet në gjuhën shqipe.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët përdorin kryesisht literaturën virtuale si më të përditësuar dhe më të përshtatshme për programin e studimit. Aksesin në bibliotekën fizike dhe në atë virtuale ofrohet nga institucioni pa pagesë si për studentët ashtu edhe për stafin.</p> <p>Studentët mund të aksesojnë nga biblioteka virtuale deri në 10 tituj. Literaturë kjo e mjaftueshme për të mbuluar argumentet karakterizuese të këtij programi studimi.</p> <p>Aksesin në bibliotekën fizike është i mundur gjatë gjithë orarit që institucioni qëndron hapur. Studentët konfirmojnë përdorimin e bibliotekës edhe si ambient të qetë studimi.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur edhe me PC me akses në internet dhe me mundësi për të aksesuar bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, u shpjegua procedura e brendshme e vlerësimit/modifikimit të syllabuseve brenda normës 20% të lejuar nga aktet ligjorë në fuqi. Në to përcaktohet edhe nevoja për azhurnimin e literaturës dhe përgatitja e kërkesave për literaturë të re përpara fillimit të vitit akademik përkatës.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Aksesin në bibliotekën fizike është i mundur gjatë gjithë orarit që institucioni qëndron hapur. Studentët konfirmojnë përdorimin e bibliotekës edhe si ambient të qetë studimi.</p> <p>Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 11:00-15:00.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë

në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Bazuar në RVB, KU IKT disponon një sistem të informatizuar të menaxhimit të brendshëm [dok. 48, Sistemi i Menaxhimit të institucionit] i cili aksesohet online në adresën <i>sys.cit.edu.al</i>.</p> <p>Sistemi i menaxhimit i informatizuar është në ndihmë të të gjithë informacionit që lidhet me studentët. Por dokumenti zyrtar trajtohet sipas akteve ligjore/nën ligjore në fuqi nga zyra e sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse.</p> <p>Nga vizita në institucion, dhe në veçanti me sekretarinë mësimore vihet re përdorimi i sistemit informatik si nga pedagogët ashtu edhe nga sekretaria. Më pas ky informacion, pasqyrohet në regjistrat zyrtar fizik i cili firmoset nga sekretari dhe dekani.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm është një platformë informatike e zhvilluar nga vetë stafi i KU IKT dhe azhurnohet me module të reja sa herë lind nevoja.</p> <p>Sistemi i informatizuar është në ndihmë të nevojave të menaxhimit të institucionit por ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën <i>Google for education</i> e cila lejon përdorimin e adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain <i>@cit.edu.al</i></p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Akcesi në sistemin e informatizuar realizohet në bazë përdorues/fjalëkalim. Studentët kanë akses në lexim të të dhënave të tyre në lidhje me avancimin akademik. Të dhëna këto që plotësohen nga sekretaria mësimore.</p>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Sistemi i informatizuar, është në zhvillim të vazhdueshëm. Komunikimi kryesor bazohet në shkëmbim të postës elektronike (studentët kanë postë elektronike të personalizuar të formës <i>emër.mbiemër@cit.edu.al</i>).</p> <p>Gjithashtu studentët dhe stafi i KU IKT kanë akses në Class Room Virtual që mund të përdoret në mënyrë interaktive në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies.</p>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Sistemi i menaxhimit nga ana e sekretarisë mësimore lejon filtrimin e të dhënave në bazë të kriterëve specifike si programi i studimit, viti akademik, qyteti, emri etj.</p> <p>Raportimet kryesisht kryhen nëpërmjet platformës Google Forms si për pyetësorët e plotësuar nga studentët për vlerësimin e lëndëve/pedagogëve po ashtu edhe për pyetësor të ndryshëm në funksion të institucionit Përpunimi i pyetësorëve bëhet në bazë Microsoft Excel [dok. 36, modelet e pyetësorëve për programet e studimit; dok 36.1 Pyetësor, përgjigjet sem. II VA 2018-2019; dok. 65, Gjurmimi i studentëve ndër vite;]</p>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen	Faqja ueb e institucionit KU IKT është www.cit.edu.al e cila është e

me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	aksesueshme në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në të gjenden informacionet kryesore mbi institucionin, dokumentet publik në lidhje me licencimin, akreditimin, rregulloreve [https://cit.edu.al/about-us/]. Informacioni i paraqitur në këtë faqe është i përditësuar dhe në të gjenden edhe publikimet për vende të lira pune në IKT sikurse është përmendur edhe në përgjigjen më sipër të standardit IV.1.3			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion, KU IKT bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik (janar-dhjetor). Raporti i auditit, i depozituar në QKB, përmban të gjitha detyrimet dhe të ardhurat sipas bilancit të institucionit. Të ardhurat administrohen dhe menaxhohen sipas buxhetit të miratuar nga ortaku i vetëm për çdo njësi akademike dhe administrative. Gjithashtu institucioni harton një raport të përgjithshëm dhe jo vetëm financiar i cili depozitohet në institucionet përkatëse (ministra përgjegjëse për arsimin) sipas akteve ligjore në fuqi. [dok. 26, Raport Institucional për MASR 2018-2019].
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Në dispozicion të GVJ nuk është vendosur një raport financiar i detajuar për program studimi. Ajo që disponohet është në nivel institucioni [dok. 64, Buxheti sipas njësive kryesore] ku detajohen shpenzimet të ndara në zërat kryesor. Gjithashtu, për pjesën e të ardhurave ka një realizim për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 [tab. 18 në RVB] si dhe një parashikim për vitin akademik aktual 2019-2020 si dhe parashikime për dy vitet në vijim. [tab. 18.1 në RVB]. Këto të dhëna janë në nivel institucioni. Në dokumentet mbështetëse për planin e financimit të institucionit kemi edhe miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara [dok. 35, Urdhër Ekzekutimi për Tarifat]. Referuar [dok. 26, Raport Institucional për MASR 2018-2019] të ardhurat realizohen kryesisht nga (viti akademik 2018-2019): <ul style="list-style-type: none"> ➤ 60% tarifat e shkollimit; ➤ 37% sponsorizim nga ortaku ➤ 3% të tjera

	<p>Për vitin akademik 2019-2020 (parashikim).</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 82% tarifa shkollimi ➤ 14% sponsorizim ortaku ➤ 4% të tjera <p>Të dhënat e paraqitura në këtë raport nuk përputhen me ato të paraqitura në [tab. 18 në RVB] dhe në dokumentin 26 për të njëjtin vit akademik. Mospërputhja nga ana e vlerave numerike për të ardhurat totale të paraqitur në këto dokumenta është me rreth 50% të vlerave totale. Mospërputhje ka edhe midis zërave të ndryshme të këtyre tabelave edhe për vitin akademik 2019-2020 (parashikim).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB, KU IKT kryen auditim të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë në sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës).</p> <p>Bazuar në raportet e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe në veçanti formati i tabelës 18 në RVB institucioni paraqet një pamje të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, sponsorizime nga Ortaku, donacione dhe aktivitete të tjera.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni harton raporte të brendshëm audituese si dhe ka raport auditiv çdo vit fiskal. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Në dispozicion për GVJ është vënë raporti i auditimi për vitin fiskal 2018 [Dok. 56, Raport i auditit të jashtëm]. Ky është një raport përmbledhës ku audituesi (Net-SFS Kreston sh.p.k.) raporton një humbje financiare të institucioni KU IKT.</p> <p>Vazhdueshmëria financiare garantohet kryesisht nga vetëm dy burimet të ardhurash, tarifat e shkollimit si dhe në përqindje të lartë nga financimi i ortakut të vetëm që për vitin akademik 2018-2019 përbën rreth 37% të të ardhurave totale të institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, sidomos në takimin me stafin akademik, u përmend fakti që institucioni ka garantuar vazhdueshmërinë e tij financiare falë financimit të ortakut të vetëm që prej themelimit të institucionit [dok. Shënime në vizitë].</p> <p>Gjithashtu, përmendet edhe fakti që në vitin 2019 është bërë një ndryshim në pronësinë e institucionit.</p>

	Aftësia e institucionit për të vazhduar aktivitetin e saj lidhet ngushtësisht me aftësinë dhe mbështetjen financiare të ortakut të vetëm të shoqërisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në statutin e KU IKT [dok. 5, Statuti i KU IKT] dhe akteve rregullatore të brendshëm të institucionit [dok. 7, Libri i Rregulloreve Institucionale], ka një organizim të politikave dhe proceduarave transparente që mbulojnë një cikël të plotë akademik nga hyrja e studentëve në vitin e parë akademik deri në përfundim të ciklit përkatës. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, politikat specifike janë të detajuara në rregulloren përkatëse [dok. 12, Rregullore e programit të studimit Bsc Inxhinieri Kompjuterike dhe IT].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se: Politikat dhe procedurat që KU IKT ndjek nga hyrja deri në përfundim të ciklit të studimit për studentët garantohej barazia dhe e drejta në të gjitha proceset akademike, shoqërore dhe sociale. Nuk ka diferencim sociale, ekonomike, gjinie, moshe, etnie apo kombësie në nivel institucioni. Kjo vërehet edhe nga prania e studentëve edhe të huaj (jo në këtë program studimi), studentëve me të ardhura të ulëta ekonomike (financime me bursa), student të gjinive të besimeve të ndryshme fetare etj.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të	Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve miratohen në nivel departamenti dhe institucioni. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit [https://cit.edu.al/admission-requirements/] ku aktualisht janë të publikuara kriteret deri për vitin akademik 2021-2022. Procedurat e aplikimit janë në bazë të udhëzimeve të MASR dhe ndjekin portalin e aplikimit U-Albania sipas periudhës dhe udhëzimeve

<p>aksesueshme nga publiku.</p>	<p>të përcaktuara nga MASR.</p> <p>Kriteret janë lehtësisht të kuptueshme nga kandidatët për student dhe mund të aksesohen online nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Informacione të detajuara jepen edhe në lidhje me bursat si dhe tarifatat dhe detyrimet e ndryshme të cilat bëhen publike në faqen e internetit të institucionit. Studentët mund të marrin një informacion të hollësishëm mbi atë se çfarë bursash ofron institucioni dhe cilat janë tarifatat e përdorura prej tij.</p> <p>Informacioni i detajuar gjendet edhe në udhëzuesin e studentit [dok. 17, Guida e studentit]</p> <p>KU IKT publikon në faqen zyrtare të dhëna dhe formularë për procedurën për pezullim të studimeve, ndryshim/transferim të programeve të studimit etj.</p> <p>Këto informacione mund të merren edhe në zyrën e karrierës dhe atë të sekretarisë mësimore brenda institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>KU IKT harton, miraton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Këto i bën publike në sistemin U-Albania sipas udhëzimeve të MASR por edhe në faqen zyrtare të institucionit [https://cit.edu.al/admission-requirements/].</p> <p>Kriteret e veçanta për vitin akademik 2020-2021 janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 70% vlerësimi i mesatares ➤ 30% vlerësimi mesatar në: Matematikë, Fizikë dhe Informatikë ➤ të paktën notën 6 (gjashtë) në provimin e Maturës Shtetërore për gjuhën e huaj, ose në provimin me zgjedhje. <p>Në kushtet kur ky kriter nuk plotësohet, kandidati për student duhet të ketë fituar të paktën nivelin B1 të një prej testeve ndërkombëtare, të specifikuar në udhëzimet e MASR. Nga ky kriter përjashtohen kandidatët për studentë, të cilët kanë ndjekur shkollën e mesme në gjuhën angleze.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për programin e studimit mbasi miratohen në nivelin institucioni, dërgohen në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si kritere të përzgjedhjes së kandidatëve për vitin e ardhshëm akademik. Të dhëna që më pas përdoren në sistemin U-Albania në nivel kombëtar për rankimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.</p> <p>Për shtetasit e huaj aplikohen të njëjta kritere si edhe për shtetasit shqiptarë.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret, programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për një vlerësim sa më objektiv nga kandidatët për student publikohet në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Gjatë takimit në institucion me përfaqësues të drejtuesve si dhe të personelit akademik u vu re një qasje e përhapjes dhe marketingut të institucionit kryesisht nëpërmjet ish studentëve dhe opinionit të mirë që</p>

	<p>ata kanë patur për institucionin. Gjithashtu përdoren edhe rrjetet sociale për të bërë të njohur veprimtaritë e institucionit si dhe përdorimi i shkollave verore kryesisht për gjimnazistët si një mënyrë e njohjes së institucionit dhe asaj çfarë ofrohet.</p> <p>Dokumentet dhe kriteret zyrtare gjenden në formën e udhëzuesit të studentit dhe në faqen ueb të institucionit të aksesueshme online nga kushdo.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit.</p> <p>Të dhëna të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit [dok. 17, Guida e studentit].</p> <p>Në fillimi të çdo semestri akademik zhvillohet një javë orientuese me studentët në lidhje me lëndët që do të zhvillohen, kriteret dhe procedurat për të frekuentuar, përvetësuar dhe për tu vlerësuar në secilën lëndë</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar edhe në librin e rregulloreve institucionale [dok. 7, Libri i rregulloreve] në Kapitullin VI jepen kriteret për njohjen dhe transferimin e studimeve të mëparshme. Këto të dhëna reflektohen në mënyrë specifike edhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit [dok. 12, rregullore e programit të studimit Bsc, Inxh. Kompjuterike dhe IT].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Sikurse në kriterin V.2.1 më sipër, studentët informohen mbi procedurat e vlerësimit të dijeve në fillim të çdo semestri akademik (java e orientimit).</p> <p>Nga takimi në institucion, e konfirmuar gjatë takimeve me grupe të ndryshme si në takimin me studentët, takimin me përfaqësuesin e departamentit dhe përfaqësues të sekretarisë u konfirmuan procedurat që studentët duhet të ndjekin për t'u ankimuar një vlerësim si dhe njohja që ata kanë që në fillim të lëndës me kriteret specifike të secilës prej tyre.</p>
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Procedurat dhe kriteret e punimit të temës së diplomës bëhen të qarta që në pranim të studentëve në vitin e parë por përsëriten në semestrin e pestë (viti i tretë). Studentëve u vihet në dispozicion manuali i punimit të temës së diplomës [dok. 15, Manuali i punimit të temës së diplomës]</p> <p>Gjithë procesi i përzgjedhjes së temës, miratimi dhe caktimi i pedagogut udhëheqës përfundon brenda semestrit të pestë të ciklit të studimeve. Departamenti, nëpërmjet sekretarisë/regjistrarit bën njoftimet përkatëse për</p>

	<p>procedurat dhe u sugjeron studentëve fushat e mundshme dhe temat e diplomimit [dok. Listë e temave të propozuara], si dhe pedagogët udhëheqës përkatës. [dok. 15.1, Modeli i përcaktimit të temës së diplomës]</p> <p>Edhe nga takimi në institucion me përfaqësues të studentëve, u konfirmuan procedurat dhe hapat që ndiqen në përzgjedhjen e temës së diplomës, zhvillimit të saj dhe mbrojtja.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni harton në mënyrë periodike materiale dhe evente informuese/promovuese për programet e studimit që ofron, mundësitë për bursa si dhe mundësitë e punësimit për çdo profil diplomimi [dok. 37; 37.1; 37.2; 37.3, Katalogu i veprimtarive të KU IKT].</p> <p>Informacione të detajuara mbi evente informuese gjenden edhe në faqen ueb të institucionit [https://cit.edu.al/events/].</p> <p>Organizohen evente në gjimnaze të ndryshme, kryesisht në Tiranë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit.</p> <p>Informacione të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit [dok. 17, Guida e studentit].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Shpjegime të shumta mbi ndjekjen e programit, lëndët, detyrimet akademike dhe ato administrative, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin, jepen që në fillim prej stafit akademik si dhe u dërgohet me postë elektronike të gjithë studentëve të regjistruar edhe prej sekretarive mësimore.</p> <p>Detaje specifike jepen edhe në plan-programet e lëndëve që u vihen në dispozicion studentëve në javën e parë të fillimit të secilës prej tyre [dok. 18; 18.1; 18.2, Silabuset].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>KU IKT informon si studentët potencial si edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofrohen në përfundim të këtij programi studimi.</p> <p>Studentët e regjistruar, në mënyrë periodike informohen nga zyra e burimeve njerëzore dhe nga zyra e karrierës mbi mundësitë e punësimit [dok. 43, Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat].</p> <p>Institucioni organizon me studentët edhe vizita në institucione partnere apo me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi [dok. 44a; 44b; 44c; 44d; 44e,</p>

	Marrëveshjet institucionale].			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	I gjithë informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor (orari mësimor, plani mësimor, silabusët e lëndëve, njoftime të ndryshme) u komunikohen studentëve nga koordinatori i programit të studimit ose/dhe nga sekretaria mësimore nëpërmjet publikimit në këndin e njoftimeve ose/dhe online nëpërmjet postës elektronike.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	KU "IKT" ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm të zhvilluar prej stafit i cili aksesohet nga studentët dhe stafi në bazë të përdorues/fjalëkalim. Studentët njoftohen mbi vlerësimet e tyre si dhe ecurinë formues në tërësi. Përdorimi i platformës <i>Google for education</i> , dhe në rastin konkret të adresave të postës elektronike dhe të hapësirës së ruajtës virtuale (Google Drive) lejon shpërndarjen e informacionit dhe aksesin e tij në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni KU IKT disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Këto të dhëna hidhen në Regjistrin e Diplomimeve dhe bashkë me numrin e studentëve të regjistruar etj., deklarohen sipas kuadrit ligjor në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Për programin specifik, objekti i këtij raporti, aktualisht nuk ka student të diplomuar pasi është brezi i parë i studentëve që arrijnë në përfundim gjatë këtij viti akademik
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re plotësimi i dokumentacionit ligjor në formë shkresore. U verifikua regjistri themeltar i studentëve për këtë program studimi si dhe regjistri i arritjeve akademike nga ku rezultojnë, në vitin akademik: <ul style="list-style-type: none"> ➤ 2017-2018: 38 studentë të regjistruar (5 të larguar) ➤ 2018-2019: 39 studentë të regjistruar (9 të larguar) ➤ 2019-2020: 33 studentë të regjistruar (0 të larguar) Në të dy këto regjistra u kontrolluan në mënyrë rastësore të dhënat për gjashtë student (dy për çdo vit akademik), nga ku rezultoi se dosjet personale të studentëve ishin të plota duke përmbajtur:

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kontratë individual mes studentit dhe KU IKT ➤ Deklaratë e studentit konform modelit të miratuar nga MASR ➤ Diploma e shkollës së mesme së bashku me notat e noterizuar ➤ Dokument identifikimi ➤ Foto ➤ Certifikatë të gjuhës angleze nëse nuk ishte në diplomën e shkollës së mesme. <p>Gjatë kësaj vizite, dy nga studentët e mësipërm kishin ndërruar degë brenda institucionit. Të gjitha këto ndryshime ishin reflektuar në regjistrin themeltar përkatës.</p> <p>Këto të dhëna nga ana e sekretarisë mësimore menaxhohen edhe në format elektronik. Por duke qenë detyrimi ligjor mbajtja e dokumenteve dhe regjistrave fizik, hedhja e të dhënave në dy formate (fizik dhe elektronik) në mënyrë manuale nga stafi i sekretarisë përbën një ngarkesë në kohë dhe burime njerëzore që mund të lëri shkasë për gabime njerëzore të paqëllimshme. Për të kontrolluar nëse ka pasaktësi, të dhënat e hedhura nga sekretari kontrollohen nga një sekretar i dytë.</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përmbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e aktivitetit të sekretarisë mësimore [dok. 11, Rregullore e sekretarisë mësimore].</p>								
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi elektronik i menaxhimit të brendshëm është një platformë softuerike e krijuar nga vetë stafi i institucionit dhe aksesit në të bëhet me përdorues/fjalëkalim. Të dhënat që raportohen janë përpunuar në mënyrë të përmbledhur duke hequr çdo referencë për studentët apo që të mund të identifikojnë studentët kjo në kuadër të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo saktësohet edhe në statutin e KU IKT [dok. 5, Statuti i KU IKT].</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Për çdo program studimi hartohen të dhëna statistikore të përmbledhura për gjithë procesin dhe aktivitetin e studentëve nga pranimi në dalje për program studimi. Këto të dhëna jepen të përmbledhura në bazë njësie kryesore (Fakultet) edhe në raportin drejtuar MASR [dok. 26, Raporti Institucional].</p> <p>Në KU IKT është ngritur edhe rrejtja Alumni [dok. 55.1, Plani i aktiviteteve Alumni; dok. 55.2, Fokus Grup me Alumni; dok. 55.3 Takime të Alumni]. Për programin specifik nuk ka akoma student të diplomuar pasi është brezi i parë që arrin në përfundim të këtij programi studimi për këtë vit akademik.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #cccccc;">Nuk përmbushet</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="font-weight: bold;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në statutin e KU IKT [dok. 5, Statuti i KU IKT], prani a e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale. Me vendim të senatit akademik [dok. 25, Vendimi i senatit akademik nr. 17] numri i përfaqësuesve student në senat është rritur nga një në tre përfaqësues.</p> <p>Në KU IKT ekziston edhe Këshilli Studentor [dok. 6, Organigrama] i cili kryen aktivitetin në bazë të rregullores së veçantë [dok. 7, Libri i Rregulloreve Institucionale].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas statutit dhe rregulloreve institucionale të KU IKT, studentët marrin pjesë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Këshillin e fakultetit ➤ Këshillin e Etikës ➤ Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ➤ Komiteti i Bursave ➤ Senati Akademik, Etj. <p>Përveç pjesëmarrjes në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve dhe anketimeve për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve [dok. 36.1, Pyetësori-Përgjigjet Sem II 2018-2019 Bsc Inxh Kom dhe IT].</p> <p>Të dhëna që analizohen në formë të përmbledhur statistikore me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së institucionit [dok. Vlerësimi i programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë dy semestrave për çdo vit akademik bazuar në planin mësimor përkatës [tab. 10 në RVB] me një ngarkesë jo më tepër se 20-25 orë javore në auditor.</p> <p>Plani mësimor është i organizuar konform VKM 41, datë 24.01.2018. Megjithatë kërkohet një përshtatje më e mirë e lëndëve sipas veprimtarive formuese [tab. 9, në RVB] sidomos ndarja në lëndë karakterizuese dhe ato të formimit bazë.</p> <p>Nga takimi në institucioni, kjo mospërputhje vjen si pasojë e ndryshimit të legjislacionit dha kategorizimit të grup-lëndëve nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Hyrja në fuqi e VKM 41 në vitin 2018 me efekt nga viti akademik 2018-2019 prekte edhe programet ekzistuese të organizuar me legjislacioni në momentin e hapjes së tyre.</p> <p>Me shqyrtimin e procesit të parë të akreditimit dhe sugjerimeve/vërejtjeve/ propozimeve përkatëse do të ndryshohen edhe llojet dhe kategorizimet e lëndëve për tu përshtatur më mirë legjislacionit në fuqi.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Me përfshirje e studentëve në grupet e interesit dhe organet kolegjiale, institucioni garanton marrjen dhe përfshirjen e opinionit dhe sugjerimeve të studentëve gjatë gjithë procesit të përmirësimit të brendshëm.</p> <p>Mendimi i studentëve jepet kryesisht në formë anketimesh të cilat analizohen në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit në institucion mbi procedurat, rregulloret të drejtat dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Ne faqen ueb të institucionit janë të publikuara të gjithë formularët dhe procedurat që studentët duhet të ndjekin në raste ankimit të një vlerësimi dhe hapat që ndiqen deri në zgjidhjen e problematikave të mundshme.</p> <p>Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në KU IKT është e ngritur dhe funksionon zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Për të rritur ndërveprimin me studentët në vitin akademik 2019-2020 është shtuar edhe një pozicion administrativ, ai i Koordinatorit të Marrëdhënieve me Studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës shërben si burimi primar i informacionit për studentët. Më pas studentët ndiqen nga pedagogët këshillues akademik (tutor) [dok. 41, Lista e pedagogëve këshillues akademik për studentët] duke përfshirë këtu jetën e tyre akademike dhe atë shoqërore të lidhur me iniciativat e institucionit.</p> <p>Stafi akademik ka të afishuar në zyrat përkatëse oraret e takimit me studentët.</p> <p>Në këtë kuadër Koordinatori i Marrëdhënieve me Studentët (edhe gjatë takimit në institucion) konfirmoi angazhimin e studentëve në dhe asistimin e tyre jo vetëm në orientimin akademik por edhe atë shoqëror e social. Studentët e viteve më të larta orientohen, edhe në bazë të aftësive të tyre personale, të ndihmojnë studentët e viteve më të ulëta në avancimin e tyre akademik.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve [dok. 43, Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat].</p> <p>KU IKT informon studentët edhe për mundësi bashkëpunimi/studimi me institucione partnere [dok. 44.2, Marrëveshje bilaterale mes Erasmus+ dhe CIT 2019-2020], [dok. 44.2, Marrëveshje me programin Mevlana Turqi për mobilitet 2020]. Studentët orientohen mbi kriteret, mundësitë dhe avantazhet e pjesëmarrjes në këto programe bashkëpunimi [dok. 46, Studentët pjesëmarrës në Work_Travel USA], [dok. 47, Studentët Pjesëmarrës në Ceepus].</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës përpilon të dhëna statistikore për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre mbas diplomimit [dok. 65, Gjurmimi i studentëve ndër vite]. Gjithashtu nëpërmjet rrjetit Alumni [dok. 55.1, Plani i aktiviteteve Alumni; dok. 55.2, Fokus Grup me Alumni; dok. 55.3 Takime të Alumni] përditësohen të dhënat si dhe mbahen aktiv ish studentët si shembull për studentët aktual.</p> <p>Për programin specifik nuk ka akoma student të diplomuar pasi është brezi i parë që arrin në përfundim të këtij programi studimi për këtë vit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB, Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është aktive që në vitin akademik 2012-2013, e ngritur me Vendim Nr. 16 të Senatit Akademik, datë 22.05.2013 [dok. 24, Vendimi nr. 16 i Senatit Akademik mbi krijimin e NJSBC].</p> <p>Kjo njësi bazon punën e saj në statutin e institucionit dhe të gjithë akteve rregullatorë të brendshëm, në veçanti në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook) [dok. 16, Manuali i sigurimit të cilësisë – QAU Handbook].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të</p>	<p>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal që</p>

<p>ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>përbëhet nga pesë anëtar, nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); një është përfaqësues i personelit administrativ; një është përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert që drejton njësinë.</p> <p>NJSBC ka për detyrë të hartojë dhe azhurnojë Manualin e Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook) [dok. 16, Manuali i sigurimit të cilësisë – QAU Handbook] në përputhje me standardet e cilësisë. Manuali i azhurnuar miratohet nga Senati i institucionit dhe u shpërndahet stafit në fillim të çdo viti akademik dhe kërkohet zbatimi i tij me rigorozitet.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucionin nëpërmjet mekanizmave dhe strukturave të brendshëm.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse (ASCAL). Akreditimi institucional është me urdhër të ministrisë përkatëse për arsimin më datë 25.03.2016 [dok. 3, Urdhër MAS për akreditim institucional nr. 139 dt. 25.03.2016] apo edhe akreditime të disa programe të tjera studimi të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit [https://cit.edu.al/about-us/] dhe gjenden edhe në faqen zyrtar të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) [https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>NJSBC organizon në mënyrë periodike (në fund të çdo semestri) anketime me studentët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen nga NJSBC dhe rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit në formë të përmbledhur për procedura vendim-marrëse. Në mënyrë specifike informacioni i anketimit përmbledhet për çdo pedagog dhe i bëhet e ditur secilit pedagog për përmirësim të vazhdueshëm si dhe përgjegjësit të departamentit përkatës.</p> <p>Departamenti ka përgjegjësinë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së programit të studimit që ofron. Në fillim të çdo viti akademik, vlerësohet përbërja e programit të studimit si dhe përputhshmëria me stafin akademik të departamentit dhe të institucionit në përgjithësi. Nëse sugjerohen ndryshime, ato kalojnë për miratim deri në senatin akademik me procedura të mirë-përcaktuara.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen,</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë struktura hierarkike organizative [dok. 6, Organigrama e KU IKT] dhe përbëhet kryesisht nga:</p>

<p>rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Komiteti i Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat (KPPK) ➤ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) <p>I pari kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e Programeve të Studimit dhe Kurrikulave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti ato të formimit Kanadez.</p> <p>I dyti kujdeset kryesisht nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në KU IKT me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Këto struktura bashkëpunojë ngushtësisht me departamentet përgjegjës të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KU IKT harton dhe përdor anketime të brendshme për vlerësimin e cilësisë dhe ecurisë së programeve të studimit.</p> <p>NJSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur dhe angazhimit të personelit akademik. Burimi kryesor i të dhënave për këto raporte dhe metodologji janë anketimet periodike me studentët [dok. 36, Modelet e pyetësorëve për programet e studimit Bsc dhe Msc].</p> <p>Gjithashtu përdoret si model vlerësimi për stafin akademik angazhimi në tre objektiva primare:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mësimdhënie ➤ Kërkim shkencor ➤ Angazhimi dhe transmetimi i dijeve në shoqëri <p>Raporte periodike raportohen pranë organeve drejtuese sipas strategjisë së zhvillimit në KU IKT [dok. 20, Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024] dhe [dok. 21, Strategjia e Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Krijimtarisë (RDC) 2014]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni kryen analiza vjetore për ecurinë e programeve të studimit duke i rishikuar ato në kontekstin e kërkesave të tregut. Fakulteti dhe njësitë bazë në analizën vjetore orientojnë programet drejt përfshirjes të çështjeve studimore konkrete duke përditësuar programet me ecurinë dhe nevojat e tregut shqiptar dhe atij ndërkombëtar sipas rastit. Në këtë aspekt institucioni ka adresuar në të gjitha instancat vendimmarrëse problematikat e gjetura dhe në raste specifike ka vendosur që të rishikojë programe të caktuara studimi si modifikimi i programeve të studimit nga Bsc dhe Msc në Inxhinieri Industriale në Bsc dhe Msc në Inxhinieri Telekomunikacionin respektivisht. Kjo bazuar në nevojat e tregut [dok. RVB].</p> <p>Gjithashtu për çdo program studimi kryhet një studim tregu mbi nevojat dhe kërkesat për specialistë të fushës që formohen nga programi i studimit specifik [dok. 54, Studimi i tregut për hapjen e programit Bsc në CE_IT].</p> <p>Për programin e studimit objekt të këtij raporti nuk ka rishikime pasi</p>

	pritet diplomimi i studentëve të parë dhe raporti i akreditimit të jashtëm për të ndjekur hapat e përmirësimit të mëtejshëm.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike, ndryshimet apo dhe rishikimet e kurrikulave dhe objektivave të tyre, pasi analizohen në njësitë bazë, propozohen në organet kolegjiale si Senati Akademik, këshillat e fakulteteve, dhe ndjekin vendimmarrjen. Gjithashtu programet e studimeve përmirësohen edhe duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të procesit mësimor nga personeli akademik dhe nga studentët. Rivlerësimi dërgohet për miratim nga Këshilli i fakultetit, për t'u miratuar më pas nga Senati. Institucioni, NJSBC dhe njësi të tjera, njëkohësisht bëjnë edhe gjurmimin e studentëve ndër vite, duke ndjekur punësimin e tyre, angazhimet që kanë, studimet e mëtejshme etj.384			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Bazuar edhe në rregulloret e brendshme të institucionit dhe sidomos në manualin e NJSBC-së, raportet e përpiluara shërbejnë për përmirësim të vazhdueshëm në nivel institucioni dhe programi studimi. Gjithashtu treguesit në raportet individuale për stafin akademik përfshijnë edhe kriteret apo parametrat që secili prej tyre duhet të përmirësojë. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimin e organet drejtuese dhe personelin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	NJSBC organizon në mënyrë periodike (në fund të çdo semestri) anketime me studentët. Rezultatet e anketimit përpunohen nga NJSBC dhe rezultatet e fituara vihen në dispozicion drejtuesve të departamentit përgjegjës për programin e studimit. Këto të dhëna shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për vlerësimin e mësimdhënies nga stafi akademik. Në mënyrë specifike informacioni i anketimit përmbledhet për çdo pedagog dhe i bëhet e ditur secilit pedagog për përmirësim të vazhdueshëm si dhe përgjegjësit të departamentit përkatës.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	KU "IKT" dhe më konkretisht Fakulteti i Inxhinierisë, synon që në bashkëpunim të ngushtë me NJSBC të kryej në mënyrë periodike vlerësimin e procesit mësimor, atë të sigurimit të cilësisë dhe evidentimit të problematikave. i tërë procesi i vlerësimit, pasi analizohet, raportohet në instancat kolegjiale vendimmarrëse. KU "IKT" në shërbim të përthithjes së informacionit, përpunimit të tij dhe nxjerrjes së rezultateve përdor si formë të drejtpërdrejtë pyetësorët për marrjen e të dhënave dhe si formë të tërthortë, tryezat dhe takimet me studentët, bashkëbisedimet etj.

	Nuk ka një mekanizëm të veçantë kontrolli për këtë program studimi, formatet janë të njëjta për të gjitha programet e tjera të studimit të ofruara.			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Metodologjia e vlerësimit mbështetet mbi vetdeklarimin. Ndërsa instrumentet për ta arritur këtë gjë kanë qenë pyetësorët në rastin e studentëve; dhe në rastin e stafit akademik dhe administrativ, pyetësorët dhe vetëvlerësimin. Rezultatet e marra nga pyetësorët, të përmbledhura e të përpunuara, bëhen publike. Marrja e informacionit nga studentet, bëhet nëpërmjet pyetësorëve dhe takimet me studentet. Ndërsa për stafin akademik, përdoret raportet për ecurinë e fakultetit nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit për departamentin si dhe vet-raportimi i stafit akademik në fund të vitit, mbi aktivitetin akademik, përmbushja e objektivave vjetor institucional e atyre personal si dhe mbi detyrat administrative që ata kryejnë. Analiza e këtyre të dhënave reflektohet në raportet vjetore që njësitë kryesore dorëzojnë pranë rektoratit. Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Pyetësorët janë përqendruar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimin e stafit nga studentet; ➤ Vlerësimin e studentëve për programet dhe lëndët; ➤ Vlerësimin e studentëve për literaturën e përdorur; ➤ Vlerësimin nga studentët për shërbimet e ofruara në KU IKT. 			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<p>Institucioni vlerëson jo vetëm përgjigjet e pyetësorëve për përmirësimin e vazhdueshëm, por gjithashtu vlerëson edhe angazhimin në shoqëri dhe transferimin e dijeve si nga stafi i institucionit ashtu edhe nga studentët.</p> <p>Kjo tregon edhe punën në grup dhe marrjen e njohurive të përgjithshme dhe specifike nga studentët gjatë periudhës studentore.</p> <p>Aftësitë e studentëve, por edhe aftësitë e stafit akademik për të transmetuar njohuri vihet re edhe në pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet të ndryshme [aktivitete në start-up dhe në gjimnaze të Tiranës] çka vlerësohet pozitivisht në vet-vlerësimin e institucionit.</p> <p>Në KU IKT është ngritur edhe rrejtja Alumni. Të dhënat dhe pyetësorë e zhvilluar me ish studentë përdoren për përmirësimin në vazhdim të institucionit. [dok. 55.1, Plani i aktiviteteve Alumni; dok. 55.2, Fokus Grup me Alumni; dok. 55.3 Takime të Alumni]. Për programin specifik nuk ka akoma student të diplomuar pasi është brezi i parë që arrin në përfundim të këtij programi studimi për këtë vit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>I gjithë aktivitetit i NJSBC-së rregullohet në statutin e institucionit dhe në librin e rregulloreve. Në veçanti bazohet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook) [dok. 16, Manuali i sigurimit të cilësisë – QAU Handbook] në përputhje me standardet e cilësisë. Manuali i azhurnuar miratohet nga Senati i institucionit i cili si organ kolegjal dhe vendim-marrës është drejtpërsëdrejti i përfshirë në procesin e përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Në kuadër të rritjes së cilësisë vlerësohet pozitive edhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare si Erasmus+ [dok. 44.2, Marrëveshje bilaterale mes Erasmus+ dhe CIT 2019-2020] dhe programi Malvina [dok. 44.3, Marrëveshja me programin Malvina Turqi për mobilitet 2020].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB, sikurse u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion, u vu re se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë kanë detyra të përcaktuara qarët dhe me aktet rregullatorë të brendshme si në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook) [dok. 16, Manuali i sigurimit të cilësisë – QAU Handbook]. Kjo instancë bashkëpunon edhe me grupin e punës për vlerësimin e brendshëm (GVB) dhe organet drejtuese sipas hierarkisë së institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas vendimit të krijimit të NJSBC [dok. 24, Vendimi nr. 16 i Senatit Akademik mbi krijimin e NJSBC], NJSBC-ja është organ kolegjal që përbëhet nga pesë anëtar, nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore (një për secilën njësi); një është përfaqësues i personelit administrativ; një është përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert që drejton njësinë. Kjo përbërje garanton përfaqësimin e të gjithë grupeve të interesit në institucion për vlerësimin objektiv të gjetjeve dhe propozimin e përmirësimeve të mundshme.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtarëve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje</p>	<p>NJSBC por edhe grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga anëtarë të brendshëm të institucionit.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të silabuseve të lëndëve.</p>

me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ka edhe tentativa bashkëpunimi me universitete jashtë Shqipërisë për diploma të dyfishta apo njohje reciproke të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Në faqen zyrtare në web publikohen raporte të përmbledhura për programet e studimit të cilat evidentojnë kryesisht pikat e forta të institucionit [https://cit.edu.al/about-us/].</p> <p>Të dhëna më të detajuara u ofrohen studentëve gjatë nënshkrimit të kontratës kur regjistrohen si studentë në një program studimi [dok. 49, Kontratë tip studenti]. Në këtë fazë studenti njihet me dokumentin e performancës së institucionit dhe në veçanti për programin e studimit të përzgjedhur.</p>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të pyetësorëve të organizuar jepen në formë të përmbledhur. Të dhënat jepen në formë anonime dhe statistikore në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. [dok. 36.1, Pyetësori-Përgjigjet Sem II 2018-2019 Bsc Inxh Komp dhe IT]</p> <p>Të përmbledhur jepen edhe të dhëna tërësore si për programe studimi ashtu edhe për institucionin të publikuara në faqen ueb zyrtare [https://cit.edu.al/].</p> <p>Të dhënat e aksesueshme nga stafi në kuadër të raporteve apo anketimeve në lidhje me cilësinë e brendshme apo raporte specifike mbi vlerësimin e stafit janë konfidenciale në qasjen e plotë ndërsa të përpunuara bëhen publike brenda institucionit.</p> <p>Stafi akademik në nënshkrimin e kontratës së punës pranë KU IKT, pranon të ruajë të dhënat sensitive me të cilat haset gjatë aktiviteti në KU IKT [dok. 27, Kontratë pune tip].</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>NJSBC dhe GVB paraqesin raportet mbi gjetjet dhe vlerësimet si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Në përmblyllje të raporteve [dok. 59, Raporti i vlerësimit të programit Bsc në Inxh Komp dhe IT] ka një analizë mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t’u fokusuar në evidentimin e pikave të forta. Për pikat e dobëta dhe sugjerimeve dhe masat që mund të ndërmerren, mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore por edhe institucioni për ti përmirësuar ato në të ardhmen.</p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në	<p>KU IKT ka organizuar trajnime informuese dhe ndërgjegjësuese për stafin dhe studentët në rolin e tyre aktiv në sigurimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC e cila ka në fokusin e saj vlerësimin dhe sugjerimet për</p>

kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të institucionit dhe në veçanti për programet e studimit, ka në përbërjen e saj një staf të konsoliduar prej vitesh (6 vite për kryetarin dhe nga 4 vite për dy anëtar nga stafi) [tab. 24, RVB, Të dhënat për anëtarët e NJSBC]. Prania e një stafi të konsoliduar është tregues i një vazhdimësie të politikave institucional në kuadër të përmirësimin të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nëpërmjet përfshirjes në NJSBC të përfaqësuesve të strukturave të ndryshme të institucionit (përfaqësues të dy fakulteteve, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të stafit administrativ) dhe përcimi i gjetjeve në grupet përkatëse të interesit, KU IKT informon dhe ndërgjegjëson stafin akademik, administrativ dhe studentët rreth sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. Në takimin në institucion u konfirmua se NJSBC dhe organet drejtuese në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni organizojnë vazhdimisht veprimtari informuese për stafin dhe studentët në drejtim të përmirësimin të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, “Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Arsimit cilësor i cili zhvillohet 100% në anglisht;
2. Cilësia e kurrikulave të ofruara për programin e studimit;
3. Vlerësimi i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët, për këtë program studimi;
4. Shkëmbime në rritje të studentëve të këtij program studimi midis universiteteve partnere;
5. Infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore për leksione, seminare dhe praktika në funksion të këtij programi studimi;
6. Bibliotekë e mirë-pajisur me literaturë fizike të rëndësishme për programin e studimit, qasje në një bibliotekë dixhitale dhe anëtarësim në revista shkencore;
7. Mbështetje ndaj “Klubeve Studentore”.

Pika të dobta:

1. Pamjaftueshmëria e ambienteve të bollshme për një arsimim cilësor sipas standardeve;
2. Paqëndrueshmëria e stafit akademik me kohë të plotë në tre vitet e fundit akademike;
3. Institucioni KU IKT rezulton me humbje financiare. Vazhdueshmëria financiare garantohej kryesisht nga vetëm dy burimet të ardhurash, tarifat e shkollimit si dhe në përqindje të lartë nga financimi i ortakut të vetëm;
4. Mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi i departamentit përgjegjës për programin e studimit është në një masë shumë të ulët.

Rekomandime:

1. Të rriten hapësirat në dispozicion në varësi edhe të numrit të studentëve;
2. Të përmirësohet baza laboratorike për programin e studimit;
3. Të rritet qëndrueshmëria e stafit akademik me kohë të plotë në lidhje me programin e studimit të analizuar;
4. Të arrihet qëndrueshmëria financiare e institucionit për të garantuar vijueshmërinë akademike;
5. Mbulimi i lëndëve të garantohet në pjesën më të madhe nga personel akademik i departamentit përgjegjës për programin e studimit.

Conclusions of the evaluation of the first cycle Bachelor study program in “Computer Engineering and Information Technology”, University College “Canadian Institute of Technology”**Strengths:**

1. Teaching activity is 100% in english language;
2. Study program with contemporary high quality curricula;
3. Periodic academic staff performance evaluation also by students opinion;
4. Increasing student exchange activity for the evaluated study program with partner universities;
5. Classes, rooms and labs are equipped with modern and contemporary auxiliary technology infrastructure in function of the evaluated study program;
6. Well equipped library with physical literature relevant to the study program, access to a digital library and membership in scientific journals;
7. Support to “Student clubs”.

Weakness:

1. Insufficiency of ample space facilities for a quality education according to standards;
2. Instability of full-time academic staff in the last three academic years;

3. The UC CIT experiences financial losses. Financial continuity is mainly guaranteed by only two main sources of income, student tuition fees and on a high percentage from the owner financing;
4. Coverage of the teaching load by the staff of the department responsible for the study program is to a very low extent.

Recommendations:

1. Increase the available spaces/classes depending also on the number of students;
2. Improving laboratory facilities relative to the study program;
3. Improve full-time academic staff stability/mobility relative to the analyzed study program;
4. Achieve financial stability/security of the institution to guarantee academic continuity;
5. Teaching load to be guaranteed for the most by the academic staff of the department responsible for the study program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X